



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 182

Tiranë – E hënë, 30 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 90/2019 datë 18.12.2019	Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme..... 14735
Dekret i Presidentit nr. 11396, datë 27.12.2019	Për shpallje ligji..... 14736
Ligj nr. 96/2019 datë 18.12.2019	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019” 14736
Dekret i Presidentit nr. 11397, datë 27.12.2019	Për shpallje ligji..... 14736
Ligj nr. 97/2019 datë 18.12.2019	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” 14737
Dekret i Presidentit nr. 11398, datë 27.12.2019	Për shpallje ligji..... 14737
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 837, datë 24.12.2019	Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020... 14737
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 838, datë 24.12.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 607, datë 27.10.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për kalimin e mjediseve të ndërtesës ‘Godina e inovacionit’ në përgjegjësi administrimi të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)”, të ndryshuar..... 14772
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 844, datë 24.12.2019	Për kalimin në pronësi nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Gjirokastër, të pronës nr. 599, me emërtim “Aerodrom fushor”, me vendndodhje në Gjirokastër, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar..... 14772

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 847, datë 24.12.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 343, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të autoriteteve licencuese dhe/ose mbikëqyrëse” 14774
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 24.12.2019	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së grantit nr. TF013972, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant të siguruara nga dhurues të ndryshëm, nën fondin e dytë të besimit shumëdhurues për Shqipërinë, për mbështetjen për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e sistemit të planifikimit të integruar (SPI) 2, miratuar me vendimin nr. 243, datë 3.4.2013, të Këshillit të Ministrave..... 14774
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 851, datë 24.12.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 387, datë 25.5.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Përmirësimi i shtresave rrugore Fushë-Krujë–Thumanë’” 14775
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 852, datë 24.12.2019	Për kalimin në përgjegjësi administrimi të shoqërisë Albgaz sh.a., të pasurive me nr. 181/80 dhe nr. 181/81, zona kadastrale 2631, Korçë.... 14778
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 853, datë 24.12.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 327, datë 27.4.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kV, Rrashbull–Golem–Kavajë” 14785
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 854, datë 24.12.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar..... 14786
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 855, datë 24.12.2019	Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të arkivit elektronik të akteve..... 14787
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 856, datë 24.12.2019	Për përcaktimin e formës, të elementeve përbërëse dhe të afatit të përdorimit të certifikatës elektronike të gjendjes gjyqësore..... 14791
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 857, datë 24.12.2019	Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të konkurrimit, formën e kohëzgjatjen e kontratës dhe metodologjinë e caktimit të tarifave për dhënien në përdorim të pasurive kulturore publike..... 14794
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 24.12.2019	Për emërimin në detyrë të drejtorit të Cirkut Kombëtar..... 14799
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 859, datë 24.12.2019	Për përbërjen, funksionimin, organizimin dhe detyrat e Komisionit për Prodhimin Biologjik..... 14800

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 861, datë 24.12.2019	Për mënyrën e njohjes së audituesve klinikë, kryerjen e procesit të auditimit dhe përcaktimin e tarifave të pagesës së audituesve.....	14802
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 863, datë 24.12.2019	Për një rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2019, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.....	14805
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 865, datë 24.12.2019	Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore.....	14806
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 869, datë 24.12.2019	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes së grantit (grant nr. TF017364), ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si Agjenci Zbatuese për Fondin Global të mjedisit (GEF), për projektin e shërbimeve mjedisore, ratifikuar me ligjin nr. 152/2014.....	14809
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 871, datë 24.12.2019	Për caktimin e ditës së premte, datë 3.1.2020, ditë pushimi.....	14810
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 872, datë 24.12.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, të ndryshuar.....	14810
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 24.12.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 389, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit”	14811
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 874, datë 24.12.2019	Për mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmës personal.....	14811
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 876, datë 18.12.2019	Për disa shtesa në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar”.....	14814
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 877, datë 18.12.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, të ndryshuar.....	14815



LIGJ
Nr. 90/2019

PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË
SË PALUAJTSHME

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, 83 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme
për individët

1. Të gjithë individët, të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, kanë të drejtë që, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, deri në datën 30 shtator 2020 të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut.

2. Ky rivlerësim mund të bëhet nga një ekspert i licencuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme nga institucionet përkatëse ose nga zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës .

3. Në rast se individë zgjedh që të bëjë rivlerësimin me një ekspert të licencuar, atëherë aplikimit të tij për rivlerësim të pasurisë së paluajtshme i bashkëlidh edhe aktin e vlerësimit të ekspertit.

4. Zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës përlogarisin:

a) bazën e tatueshme, e cila llogaritet si diferenca ndërmjet vlerës së pasqyruar në akt ekspertimi, e cila nuk mund të jetë më e vogël se çmimet minimale fiskale, dhe vlerës së pasurisë të aktit të regjistruar ose vlerës së rivlerësuar për të cilën është paguar tatimi;

b) tatimin që duhet të paguajë individë për ta regjistruar këtë rivlerësim.

5. Në rast se individë zgjedh që rivlerësimi të kryhet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me çmimet minimale fiskale në fuqi, atëherë ky fakt shprehet në formularin që i bashkëlidhet aplikimit të tij për rivlerësim.

6. Në rastin e parashikuar në pikën 5, të këtij neni, zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës përlogarisin:

a) bazën e tatueshme, e cila llogaritet si diferenca ndërmjet vlerës së dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale në fuqi dhe vlerës së pasurisë të aktit të regjistruar ose vlerës së rivlerësuar, për të cilën është paguar tatimi;

b) tatimin që duhet të paguajë individë për ta regjistruar këtë rivlerësim.

7. Në rastet kur pasuria e paluajtshme rezulton e regjistruar pa një kontratë shitjeje, atëherë, si vlerë regjistrimi, në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, konsiderohet vlera e çmimeve minimale fiskale në çastin e regjistrimit të aktit të fitimit të pronësisë.

8. Tatimi që paguhet për regjistrimin e këtij rivlerësimi është 3 për qind e bazës së tatueshme, që përcaktohet sipas pikave 4 dhe 6 të këtij neni.

9. Për rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, në zbatim të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, të bërë pas rivlerësimit, tatimi llogaritet sipas normave në fuqi mbi fitimin e realizuar, si diferenca e vlerës, në momentin e kalimit të së drejtës së pronësisë, me vlerën e rivlerësuar, për të cilën është paguar tatimi.

Neni 2

Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme në
proces regjistrimi

Objekt i këtij ligji është edhe rivlerësimi i pasurive të paluajtshme që janë në proces regjistrimi, duke përfshirë edhe pasuritë e legalizuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedurat e rivlerësimit dhe pagesës për rastet e parashikuara në këtë nen, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3

Rivlerësimi i pasurive të paluajtshme për
personat juridikë

1. Personat juridikë, të cilët kanë të regjistruar në pasqyrat e tyre financiare pasuri të paluajtshme me vlerë më të vogël se ajo e tregut, kanë të drejtë të bëjnë, brenda periudhës së zbatimit të këtij ligji, rivlerësimin me vlerën e tregut të këtyre pasurive.

2. Rivlerësimi me vlerën e tregut bëhet nga ekspertë të pavarur, të licencuar për vlerësimin e pasurisë.

3. Diferenca ndërmjet vlerës që rezulton nga rivlerësimi, me vlerën kontabël të pasurisë, reflektohet në pasqyrat financiare të vitit 2020.



4. Personat juridikë, për këtë rivlerësim, paguajnë 5 për qind të diferencës ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël të regjistruar, për pasuritë e paluajtshme. Për qëllime të zbatimit të këtij neni, personi juridik mban një kartelë të pasurisë së paluajtshme, ku evidenton vlerën përkatëse të pasurisë së paluajtshme që nga momenti i njohjes fillestare të aktivitetit dhe tatimit përkatës, të paguar sipas legjislacionit në fuqi. Diferenca ndërmjet vlerës së rivlerësimit dhe vlerës kontabël të regjistruar, nuk është objekt amortizimi për qëllime tatimore.

Neni 4

Aktet nënligjore

Ngarkohet ministri përgjegjës për financat dhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët për procedurat e zbatimit të këtij ligji dhe për përcaktimin e tarifës së kryerjes së shërbimeve të parashikuara nga ky ligj nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet deri në datën 30 shtator 2020.

Miraturar në datën 18.12.2019

Shpallur me dekretin nr. 11396, datë 27.12.2019, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET

Nr. 11396, datë 27.12.2019

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr.90/2019 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme”.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

LIGJ

Nr. 96/2019

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 8, DATË 16.12.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË PËRSHPEJTUAR PËR SUBVENCIONIMIN E PAGESËS SË QIRASË SË BANESËS PËR FAMILJET E MBETURA TË PASTREHA, SI PASOJË E FATKEQËSISË NATYRORE, TËRMETIT TË DATËS 26.11.2019”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 16.12.2019, i Këshillit të Ministrave,

“Për përdorimin e procedurës së përsheptuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”.

Miraturar në datën 18.12.2019

Shpallur me dekretin nr. 11397, datë 27.12.2019, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

DEKRET

Nr.11397, datë 27.12.2019

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr.96/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.8, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për



përdorimin e procedurës së përsheptuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, të rentit të datës 26.11.2019””.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

LIGJ
Nr. 97/2019

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 9,
DATË 16.12.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRBALLIMIN
E PASOJAVE TË FATKEQËSISË
NATYRORE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

Miraturar në datën 18.12.2019

**Shpallur me dekretin nr. 11398, datë
27.12.2019, të Presidentit të Republikës së
Shqipërisë, Ilir Meta.**

DEKRET
Nr.11398, datë 27.12.2019

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr.97/2019 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr.9, datë

16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore””.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 837, datë 24.12.2019

**PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË
PËRGJITHSHËM ANALITIK TË
PROJEKTAKTEVE, QË DO TË
PARAQITEN PËR SHQYRTIM NË
KËSHILLIN E MINISTRAVE GJATË
VITIT 2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020, sipas tabelave që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2020 Kryeministri/Zëvendëskryeministri										
Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Cështjet kryesore që parashikon të rregullojë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKIE?	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2017-2021	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore
							Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Nëse përputhet, të jepet referenca e saktë në program	Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Përgjigjuni me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 13/2016 "Për mënyrën e ofritit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqiperisë"	Projektligj	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ADISA)	Katër mujori III	Përmirësimi i mënyrës së organizimit dhe funksionimit të ADISA-s si dhe harmonizimin me përcaktimet e K.Pr.A dhe Direktivës së BE-së 2006/123 / EC të datës 12 dhjetor 2006 "Për shërbimet në tregun e brendshëm."	1. Saktësimin dhe unifikimin e terminologjisë së përdorur në përcaktimet aktuale të ligjit; 2. Rregullimin e varësive, statusit, organizimit dhe kompetencave të ADISA-s dhe organeve drejtuese të saj; 3. Përcaktimi në mënyrë shteruese i formave, mënyrave dhe kanaleve nëpërmjet të cilave ofrohen shërbimet publike në sportel; 4. Saktësimin i procedurës, afatave dhe përcaktimeve lidhur me trajtimin e ankësive apo vendosjen e tarifave për shërbimin e sportelit.	Jo	Kreu III "Shërbimet Publike", pika 3.1 "Shteti Ligjor dhe Drejtësia e Re" të Programit politik qeverisës 2017 - 2021.	1. Strategjia Ndërsëktoriale e Reformës në Administratën publike 2015 - 2020; 2. Dokumenti i politikave afatgjata për ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin nga administrata shtetërore në Shqipëri;	Ekonomike (Jo); Financiare (Jo); Sociale (Jo); Mjedisore (Jo).
2	Për rinishierimin e shërbimeve publike	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ADISA)	Katër mujori II	Përcaktimi i rregullave të hollësishme për procedurën e ndërmarrjes së risiës dhe bashkëpunimit të institucioneve në procesin e rinishierimit dhe kompetencën për realizimin e tij në zbatim të nenit 42, pika 3 e ligjit nr. 13/2016 "Për mënyrën e ofritit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë".	Përcaktimi i institucioneve përgjegjëse për zhvillimin e procedurës së rinishierimit; Subjekti të cilat kanë të drejtën për të filluar procedurën e rinishierimit; Detyrat përkatëse të ADISA-s, AKSH-t dhe institucioneve që marrin pjesë në këtë proces; Mënyrat e bashkëpunimit ndërinstancional.	Jo	Kreu III "Shërbimet Publike", pika 3.1 "Shteti Ligjor dhe Drejtësia e Re" të Programit politik qeverisës 2017 - 2021.	1. Strategjia Ndërsëktoriale e Reformës në Administratën publike 2015 - 2020; 2. Dokumenti i politikave afatgjata për ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin nga administrata shtetërore në Shqipëri;	Ekonomike (Jo); Financiare (Jo); Sociale (Jo); Mjedisore (Jo).
3	Për miratimin dhe ndarjen e tarifës ndërmjet Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe Institucioneve të Administratës Shtetërore	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ADISA)	Katër mujori III	Përcaktimi i tarifës për shërbimin në sportel të ofruar nga Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), e cila do të garantojë autonominë dhe mbështetjen financiare të ADISA-s, me qëllim reformimin e ofritit të shërbimeve dhe ofrimin në mënyrë të shpejtë, efikase dhe të përshatshme për të gjithë personat fizikë dhe juridikë	Përcaktimi i tarifës për shërbimin në sportel të ofruar nga Agjencia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)	Jo	Kreu III "Shërbimet Publike", pika 3.1 "Shteti Ligjor dhe Drejtësia e Re" të Programit politik qeverisës 2017 - 2021.	1. Strategjia Ndërsëktoriale e Reformës në Administratën publike 2015 - 2020; 2. Dokumenti i politikave afatgjata për ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin nga administrata shtetërore në Shqipëri;	Ekonomike (Jo); Financiare (Po); Sociale (Jo); Mjedisore (Jo).
4	Për disa ndryshime në Vendimin nr. 645, datë 14.9.2016 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe organizatës së Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara", të ndryshuar.	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ADISA)	Katër mujori I	Rritja e efikasitetit së strukturës së ADISA-s dhe vijimi i shtrirjes së saj nëpërmjet sporteleve në territorin e Republikës së Shqipërisë sipas planifikimeve të vitit 2020.	Riorganizimi i strukturës aktuale të ADISA duke kryer një ristrukturim në Drejtoritë dhe Sektorët përkatës si dhe shtimi e ADISA-s në territor, në përputhje me planifikimet për vitin 2020.	Jo	Kreu III "Shërbimet Publike", pika 3.1 "Shteti Ligjor dhe Drejtësia e Re" të Programit politik qeverisës 2017 - 2021.	1. Strategjia Ndërsëktoriale e Reformës në Administratën publike 2015 - 2020; 2. Dokumenti i politikave afatgjata për ofrimin e shërbimeve me në qendër qytetarin nga administrata shtetërore në Shqipëri;	Ekonomike (Jo); Financiare (Jo); Sociale (Jo); Mjedisore (Jo).
5	VKM për ndryshimin e VKM nr.222, datë 26.04.2018 "Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AKCESK)	Katër mujori I	Neni 6, pika 2 e Ligjit nr.2/2017 Për Sigurimin Kibernetikë.	Miratimi e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe infrastrukturave të rëndësishme të informacionit	Po, është degjuar për tu listuar si pjesë e kapitullit 10 "Shoqëria e Informacionit dhe media".	n/a	n/a	Jo
6	VKM për Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurimin Kibernetikë 2020-2025	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AKCESK)	Katër mujori II	Projekt vendimi propozohet si një instrument rregullor në kuadër të politikave qeveritare të përcaktuara në "Dokumentin e Politikave për Sigurimin Kibernetikë 2015-2017", miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 973, datë 2.12.2015.	Ky projekt vendim ka si qëllim arritjen e një niveli të lartë të sigurisë në rrjetet dhe sistemet e informacionit në Shqipëri nëpërmjet miratimit të Strategjisë Kombëtare për Sigurimin Kibernetikë 2019-2025 e cila mundëson plotësimin e një baze ligjore, marrjes së masave teknike dhe organizative, vendosjes së objektivitë strategjike sektoriale të përshatshme për sigurinë kibernetike dhe lehtësimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit mes subjekteve të ndryshme publike dhe private që administrojnë këto rrjete dhe sisteme.	Po, është parashikuar miratimi i tij në kuadër të kapitullit 10 "Shoqëria e Informacionit dhe media".	n/a	Parashikohet miratimi i këtij projekti akti, në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare.	Po
7	Rregullore e brendshme e Qendrës së Koordinimit Kunder Ekstremizmit të Dhunshëm	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (Qendra KKHEDH)	Katër mujori I	Plotesimi i Qendres me Rregullore të Brendshme, në përputhje të VKM nr. 737, datë 13.12.2017	Mënyren e funksionimit dhe organizimit të Qendres dhe strukturave të saj politike dhe ekzekutive.	Jo	Jo	Ne përputhje me Strategjinë Kombëtare Kunder Ekstremizmit të Dhunshëm	Nuk ka
8	Për Miratimin e Rregullores "Mbi mënyrën e funksionimit të Pikës së vetme të Kontaktit."	Projekt vendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AKSH)	Katër mujori II	Përafërimi i legjislacionit me Rregulloren (BE) 2018/1724 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 2 tetor 2018 për krijimin e një porte të vetme dixhitale për të siguruar qasje në informacione, procedura dhe ndihmë dhe shërbime të zgjidhjes së problemeve dhe ndryshimin e Rregullores (BE)	Në zbatim të ligjit nr. 66/2016 "Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë", kjo rregullore do të përcaktojë: a) lëkësat e nevojshme funksionale, teknike dhe ligjore të Pikës së Vetme të Kontaktit për shërbime në Republikën e Shqipërisë (referuar në vijim si: PVK), si porta e vetme digjitale për t'u lehtësuar ofruesit dhe përfuturuesit të shërbimeve, aksesin në informacion, procedura elektronike dhe asistencë efektive në përfuturimin e shërbimeve; b) përgjegjësinë e organeve kompetente për PVK-në dhe institucioneve ofruese të shërbimeve publike nëpërmjet PVK-së.	Kapitulli 3	N/A	Axhenda Dixhitale e Shqiperisë 2015 - 2020	Jo
9	Mbi masat për një nivel të lartë të sigurisë së rrjetëve dhe sistemeve të informacionit	Projekt vendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AKSH)	Katër mujori II	Përafërimi i legjislacionit me Direktiven e BE-së 2016/1148 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit lidhur me masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë së rrjetëve dhe sistemeve të informacionit në të gjithë Bashkimin.	Ky projekt akt planifikohet të rregullojë kornizën kombëtare mbi sigurinë e rrjetëve dhe sistemeve të informacionit (kerkesat e sigurisë, rrethimi mbi incidentet etj.)	Jo, por do të parashikohet në kapitullin 10	N/A	Axhenda Dixhitale e Shqiperisë 2015 - 2020	Jo
10	Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore".	Projektligj	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (AMBU)	Katër mujori III	Përafërimi i Direktivës 2000/60/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, 23 tetor 2000, Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave, ndryshuar me vendimin 2455/2001/EC dhe Direktivën 2008/32/EC, 2008/105/EC, 2009/131/EC, 2013/39/EU and 2013/64/EU	Plotesimi i kuadrit rregullor në fushën e menaxhimit të burimeve ujore duke transpozuar plotësisht Direktivën e BE-së	Ne aneksin ku parashikohen masat ligjore për vitet 2020-2022	Përputhjet me kapitullin 2, pikën 2.5, Infrastruktura ujore.	VKM nr.73, datë 7.2.2018, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, 2018-2027".	Po



11	"Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në llogje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, rinovimit, dokumenteve shoqëruarë, formateve të miratimit në parim, lejeve e autorizimit, kushteve të përgjithshme e të posaçme të lejeve e autorizimeve, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, si dhe afateve të vlefshmërisë".	Projektvendim	Kryeministri/Zvendës kryeministri (AMBU)	Katër mujori I	Përmirësimi i procedurave të aplikimit për leje, autorizim, si dhe përcaktimin e dokumentacionit shoqëruar që duhet të paraqesin subjektet kërkuar.	Përcaktim formularin e aplikimit për leje/autorizim sipas veprimtarive të parashikuara në ligjin 111/2012, dokumentacioni teknik e ligjor që duhet të plotësojë aplikuesi, afatet dhe procedurat e shqyrtimit të aplikimit, vendimmarrjes dhe afatet e vlefshmërisë së lejeve/autorizimit	Jo	Jo	Jo	Jo
12	Për disa ndryshime në VKM nr. 221, datë 26.4.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore"	Projektvendim	Kryeministri/Zvendës kryeministri (AMBU)	Katër mujori II	Projektvendimi është hartuar si kërkesë për plotësimin me aktet përkatëse nënligjore të Ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të Burimeve Ujore" si dhe është në vijim të miratimit të VKM-së "Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor.....", të parashikuar në pikën 2.	Ky projektakt parashikon që shqyrtimi i kërkesave për leje/autorizim për përdorim burimi ujor, nëpërmjet sistemit elektronik të bëhet nga AMBU	Jo	Jo	Jo	Jo
13	Për miratimin e tarifave të shërbimeve administrative, që lidhen me përdorimin apo shkarkimin e ujit dhe ndërtimin e objekteve a veprave ujore	Projektvendim	Kryeministri/Zvendës kryeministri (AMBU)	Katër mujori III	Projektvendimi është hartuar si kërkesë për plotësimin me aktet përkatëse nënligjore të Ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të Burimeve Ujore" si dhe është në vijim të miratimit të VKM-së "Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor.....", të parashikuar në pikën 2.	Ky projektakt parashikon tarifën që duhet të paguajë cdo subjekt që aplikon për leje/autorizim për përdorim burimi, sipas ligjit të veprimtarisë që kërkon të ushtrojë.	Jo	Jo	Jo	Jo
14	"Për miratimin e tarifave të përdorimit dhe shkarkimit të ujit"	Projektvendim	Kryeministri/Zvendës kryeministri (AMBU)	Katër mujori III	Projektvendimi është hartuar si kërkesë për plotësimin me aktet përkatëse nënligjore të Ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të Burimeve Ujore" si dhe është në vijim të miratimit të VKM-së "Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor.....", të parashikuar në pikën 2.	Ky projektakt parashikon tarifën që duhet të paguajë cdo subjekt për përdorimin e ujit dhe për shkarkimet e lëngshme.	Jo	Jo	Jo	Jo
15	"Për miratimin e kërkesave, kushteve, procedurave, fondëve të nevojshme buxhetore për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përdorimin e kadastrës kombëtare të burimeve ujore"	Projektvendim	Kryeministri/Zvendës kryeministri (AMBU)	Katër mujori III	Arsyet që kanë çuar në propozimin e këtij projektvendimi ka të bëjë me detyrimin e vendit tonë për përafrimin e kuartrijve ligjor evropian, si dhe nevojën urgjente për krijimin e një inventari në nivel kombëtar të rezervave ujore, vendndodhjeve të tyre, sasisë dhe cilësisë së tyre.	Ky projektakt do të plotësojë kuadrin ligjor ekzistues në fushën e menaxhimit të burimeve ujore, dhe do të përcaktojë rregullat dhe procedurat për mbledhjen e organizuar të të dhënave logjistikë të lidhura e të mbledhura nga burime të ndryshme, të ruajtura dhe të formuluar në sistemin e kadastrës dhe në dispozicion për përdoruesit e burimeve ujore dhe institucionet e linjës, që vepron në fushën e ujërave.	Jo	Jo	Jo	Jo
16	"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM 268, datë 6.4.2016, "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Ujit"	Projektvendim	Kryeministri/Zvendës kryeministri (AMBU)	Katër mujori I	Arsyet që kanë çuar në propozimin e këtij projektvendimi ka të bëjë me ndryshimet institucionale që ka sjelle ndryshimi i ligjit 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të Burimeve Ujore".	Ky projektakt do të bëjë ndryshimin e institucionit të STKKU-ë si dhe të qartësojë procedurën e propozimit të akteve në KKKU dhe në bashkërendimin e tyre.	Jo	Jo	Jo	Jo
17	"Për miratimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Suedisë, për formimin e kapaciteteve të Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore"	Projektvendim	Kryeministri/Zvendës kryeministri (AMBU)	Katër mujori I	Nëpërmjet kësaj marrëveshje synohet që Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore të transformohet në një institucion efektiv dhe efikas, që përmbush plotësisht kompetencat e saj ligjore, detyrat dhe përgjegjësitë.	Në zbatim të marrëveshjes, SIDA do të Mbështetë AMBU-në në procesin e hartimit të dokumenteve strategjike dhe të planifikimit si dhe në përafrimin e legjislacionit të brendshëm me acquis të Bashkimit Evropian në kuadër të kapitullit 27, të negociatave.	Jo	Jo	Jo	Jo
18	"Për karakterizimin dhe statusin e ujërave nentok"	Projektvendim	Kryeministri/Zvendës kryeministri (AMBU)	Katër mujori III	Detyrim që rrjedh nga ligji	Nëpërmjet këtij projekti synohet klasifikim i ujërave nentokësorë sipas statusit sasior dhe kimik	Po, Në kapitullin mjedisi	Jo	Jo	Jo
19	"Për mbrojtjen e ujërave nentokësor nga ndotje dhe dëmtimi i statusit të tyre"	Projektvendim	Kryeministri/Zvendës kryeministri (AMBU)	Katër mujori III	Detyrim që rrjedh nga ligji	Nëpërmjet këtij projekti synohet mbrojtja dhe përmirësimi i statusit të ujërave nentokësorë	Në kapitullin mjedisi	Jo	Jo	Jo
20	"Për planin dhe rregullat për menaxhimin e rreazkut nga përmbajtjet"	Projektvendim	Kryeministri/Zvendës kryeministri (AMBU)	Katër mujori III	Nëpërmjet këtij akti synohet përcaktimi i mënyrës së hartimit të planeve të menaxhimit të rreazkut nga përmbajtjet e dhe i procedurave të miratimit të tij.	Ky projektakt përcakton se çfarë duhet të përmbajë një plan menaxhimi, masat që ndërmerren për hartimin e tij si dhe procedurën e miratimit.	Në kapitullin mjedisi	Jo	Jo	Jo
21	"Për karakterizimin e trupave ujorë sipërfaqësorë"	Projektvendim	Kryeministri/Zvendës kryeministri (AMBU)	Katër mujori III	Detyrim që rrjedh nga ligji	Nëpërmjet këtij projekti synohet klasifikim i ujërave sipërfaqësorë sipas statusit kimik dhe ekologjik	Në kapitullin mjedisi	Jo	Jo	Jo
22	"Për krijimin e regjistrit të zonave të mbrojtura në basenat ujorë"	Projektvendim	Kryeministri/Zvendës kryeministri (AMBU)	Katër mujori III	Detyrim që rrjedh nga ligji	Nëpërmjet këtij projekti synohet identifikimi dhe shpallja e zonave të mbrojtura mjedisore	Në kapitullin mjedisi	Jo	Jo	Jo
23	"Për statusin e ujërave sipërfaqësorë"	Projektvendim	Kryeministri/Zvendës kryeministri (AMBU)	Katër mujori III	Detyrim që rrjedh nga ligji	Nëpërmjet këtij projekti synohet shpallja e statusit të ujërave si artificiale ose tepër të modifikuar	Në kapitullin mjedisi	Jo	Jo	Jo
24	"Për elementët përbërës të planeve të menaxhimit të basenave ujorë"	Projektvendim	Kryeministri/Zvendës kryeministri (AMBU)	Katër mujori III	Detyrim që rrjedh nga ligji	Nëpërmjet këtij akti synohet përcaktimi i elementeve që duhet të përmbajë një plan menaxhimi i basenat ujor	Në kapitullin mjedisi	Jo	Jo	Jo
25	"Për trajtimin e ujërave të ndotura urbane"	Projektvendim	Kryeministri/Zvendës kryeministri (AMBU)	Katër mujori III	Detyrim që rrjedh nga ligji	Nëpërmjet këtij projekti synohet përcaktimi i kërkesave për grumbullimin, trajtimin dhe shkarkimin e ujërave të ndotura urbane, me qëllim mbrojtjen e mjedisit nga efektet negative të tyre.	Në kapitullin mjedisi	Jo	Jo	PO
26	Ndryshimi i Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2016 "Për prokurimin publik"	Projektligj	Kryeministri/Zvendës kryeministri (APP)	Katër mujori I	pershtatje me Direktive e BE 2014/24; 2014/25	• Të përafrohet legjislacioni shqiptar me Acquis e BE-së, duke transpozuar ose adaptuar direktivat specifike, të cilat mbulojnë procedurat e prokurimit në sektorin klasik, sektorial dhe direktivë e riabilitimit administrativ; • Të përmirësohet ndjeshëm kuadri aktual regulator në fushën e prokurimit publik; • Të lehtësohet pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë, në procedurat e prokurimit; • Të shmanget zvarritja e procesit të prokurimit, për shkak të tejgjatësisë së procesit të ankimit administrativ; • Prokurim i qëndrueshëm, në respektim të parimeve për mbrojtjen sociale dhe mjedisore; • Lehtësi në prokurimin e shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike; • Rritja e performancës në implementimin e kontratave, nëpërmjet forcimit të monitorimit të këtij procesi.	Kapitulli I V I PKIE	Pika 2.1 "Stabiliteti makroekonomik", pika 3.1.1 "Administrata Publike dhe digitalizimi"	Strategjia Antikorrupsion, Strategjia për menaxhimin e financave publike dhe Reforma për Administratën Publike	Jo
27	VKM 914/2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"	Projektvendim	Kryeministri/Zvendës kryeministri (APP)	Katër mujori II	pershtatje me ndryshimet që do të pesojë ligji i prokurimit publik	• organizimi i procesit të prokurimit; • rregullat e përgjithshme të prokurimit; • procedurat e prokurimit; • procesi i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës; • monitorimi i zbatimit të kontratës etj. Të gjitha këto procese do të ndryshojnë si rezultat i ndryshimeve ligjore.	Jo	Pika 2.1 "Stabiliteti makroekonomik", pika 3.1.1 "Administrata Publike dhe digitalizimi"	Strategjia Antikorrupsion, Strategjia për menaxhimin e financave publike dhe Reforma për Administratën Publike	Jo
28	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për prokurimin Publik	Projektvendim	Kryeministri/Zvendës kryeministri (APP)	II	Përmirësimi i sistemit të prokurimit publik në Shqipëri	• rritja e efikasitetit së prokurimit publik; • rritja e kapaciteteve administrative në fushën e prokurimit publik; • garantimi i integritetit në fushën e prokurimit publik; • rritja e konkurrencës në fushën e prokurimit publik; • përmirësimi i sistemit elektronik të prokurimit;	Kapitulli I V I PKIE	Pika 2.1 "Stabiliteti makroekonomik", pika 3.1.1 "Administrata Publike dhe digitalizimi"	Strategjia Antikorrupsion, Strategjia për menaxhimin e financave publike dhe Reforma për Administratën Publike	Jo



29	"Për modelin e kartelës së pasurisë së paluajtshme"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASHK)	Katër muji	Ne funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë të ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	Te dhenat dhe elementet e kartelës së pasurisë së paluajtshme	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe zbatimit të Strategjisë ndërsëktoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësive në vitin 2012-2020(kapitulli II)	jo
30	"Për rregullat e hollësishme për përdorimin, administrimin dhe ruajtjen e bazës së të dhënave mbi pasuritë e paluajtshme"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASHK)	Katër muji	Ne funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë të ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	Rregullat e përdorimit të sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ruajtjen dhe administrimin e tyre	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe zbatimit të Strategjisë ndërsëktoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësive në vitin 2012-2020(kapitulli II)	jo
31	"Për modelin e certifikatës së pronësisë dhe të certifikatave për të drejtat reale mbi pasuritë e paluajtshme"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASHK)	Katër muji	Ne funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë të ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	Te dhenat dhe elementet e certifikatës së pronësive të pasurisë së paluajtshme	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe zbatimit të Strategjisë ndërsëktoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësive në vitin 2012-2020(kapitulli II)	jo
32	"Për rregullat dhe procedurat për ushtrimin e së drejtës nga personat juridikë/fizikë vendas apo të huaj për të patur akses në sistemin elektronik"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASHK)	Katër muji	Ne funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë të ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	Ërëthin e subjekteve që do të kenë të drejtën e aksesimit në sistemin elektronik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe zbatimit të Strategjisë ndërsëktoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësive në vitin 2012-2020(kapitulli II)	jo
33	"Për rregullat për procedurën e trajtimit të kërkesave nga ASHK"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASHK)	Katër muji	Ne funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë të ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	Percaktimi i rregullave , procedurave dhe afatëve në trajtimin e kërkesave të subjekteve gjatë aplikimit në ASHK	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe zbatimit të Strategjisë ndërsëktoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësive në vitin 2012-2020(kapitulli II)	jo
34	"Për procedurat e hollësishme të regjistrimit të titujve të pronësisë që nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASHK)	Katër muji	Ne funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë të ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	Percaktimi i rregullave , procedurave dhe afatëve në trajtimin e kërkesave të subjekteve që kanë titull pronësie por nuk kanë të përcaktuar sipërfaqen	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe zbatimit të Strategjisë ndërsëktoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësive në vitin 2012-2020(kapitulli II)	jo
35	"Për rregullat e hollësishme për mënyrat dhe mjetet teknike-hartografike për realizimin e përmirësimit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASHK)	Katër muji	Ne funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë të ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	Percaktimi i rregullave, mënyrave ,mjetëve për realizimin e procesit të përmirësimit në regjistrat e pasurive të paluajtshme	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe zbatimit të Strategjisë ndërsëktoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësive në vitin 2012-2020(kapitulli II)	jo
36	"Për regjistrimin e pemeve dhe të pasurive të tjera natyrore"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASHK)	Katër muji	Ne funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë të ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	Percaktimi i rregullave, dhe procedurave gjatë procedurës së regjistrimit të pemeve dhe pasurive të tjera natyrore në regjistrat e pasurive	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe zbatimit të Strategjisë ndërsëktoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësive në vitin 2012-2020(kapitulli II)	jo
37	"Për listën e shërbimeve kadastrale dhe tarifave të tyre"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASHK)	Katër muji	Ne funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë të ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	Percaktimi i listës së shërbimeve që do të ofrojnë ASHK ndaj subjekteve dhe tarifave të tyre	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe zbatimit të Strategjisë ndërsëktoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësive në vitin 2012-2020(kapitulli II)	po/Ndikim financiar dhe social
38	"Për elementet formale të aktëve notorale, vendimeve gjyqësore apo aktëve administrative që kontrollohen për efekt regjistrimi"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASHK)	Katër muji	Ne funksion të përmirësimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë të ASHK dhe detyrimeve që burojnë nga ligji "Për Kadastrën"	Percaktimi i rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga ASHK gjatë verifikimit të regjistrimit të aktëve notorale, vendimeve gjyqësore apo aktëve administrative të aplikuara për regjistrim	jo	Përputhet me programin politik të qeverisë dhe zbatimit të Strategjisë ndërsëktoriale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësive në vitin 2012-2020(kapitulli II)	jo



39	"Për të dhënat në përmbajtje të hartës kadastrale"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASHK)	Kater mujori I	Ne funksion të përmesimit të punës dhe ecurisë së veprimtarisë të ASHK dhe detyrimeve që buronin nga ligji "Për Kadastrën"	Përcaktimi i të dhënave dhe elementeve që do të përmbajë harta kadastrale e pasurive të paluajtshme	JO	Përfuthet me programin politik të qeverisë dhe konkretisht me kreun 3, "Shërbimet publike" dhe konkretisht pika 3.1 shteti ligjor dhe drejtësia e re, paragrafi 2, 3.	Miratimi i këtij projektakti është në funksion të zbatimit të Strategjisë ndërsëktorale "Reforma në fushën e të drejtave të pronësive në vitin 2012-2020(kapitulli II)	JO
40	Projektvendim "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Përcaktimi i kornizës referuese gjeodezike dhe kontrolli gjeodezik"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Kater mujori I	Detyrim ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/a të ligjit 72/2012 "Përcaktimi i kornizës referuese gjeodezike dhe kontrolli gjeodezik"	JO	Pika 3.1.1 Administrata publike dhe digitalizimi	Strategjia ndërsëktorale "Azhendë Dhehtale e Shqipërisë 2015-2020" Prioriteti Strategjik 3: Krijimi i Infrastrukturas Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore (NSDI).	JO
41	Projektvendim "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Sistemet e rrjetëve gjeografike"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Kater mujori I	Detyrim ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/b të ligjit 72/2012 "Sistemet e rrjetëve gjeografike"	JO	Pika 3.1.1 Administrata publike dhe digitalizimi	Strategjia ndërsëktorale "Azhendë Dhehtale e Shqipërisë 2015-2020" Prioriteti Strategjik 3: Krijimi i Infrastrukturas Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore (NSDI).	JO
42	Projektvendim "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Zonat e mbrojtura"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Kater mujori I	Detyrim Ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/g të ligjit 72/2012 "Zonat e mbrojtura"	JO	Pika 3.1.1 Administrata publike dhe digitalizimi	Strategjia ndërsëktorale "Azhendë Dhehtale e Shqipërisë 2015-2020" Prioriteti Strategjik 3: Krijimi i Infrastrukturas Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore (NSDI).	JO
43	Projektvendim "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Mbulesa e tokës"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Kater mujori I	Detyrim Ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/h të ligjit 72/2012 "Mbulesa e tokës"	JO	Pika 3.1.1 Administrata publike dhe digitalizimi	Strategjia ndërsëktorale "Azhendë Dhehtale e Shqipërisë 2015-2020" Prioriteti Strategjik 3: Krijimi i Infrastrukturas Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore (NSDI).	JO
44	Projektvendim "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Zonat me rrezikje natyrore"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Kater mujori I	Detyrim Ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/s të ligjit 72/2012 "Zonat me rrezikje natyrore"	JO	Pika 3.1.1 Administrata publike dhe digitalizimi	Strategjia ndërsëktorale "Azhendë Dhehtale e Shqipërisë 2015-2020" Prioriteti Strategjik 3: Krijimi i Infrastrukturas Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore (NSDI).	JO
45	Projektvendim "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Përdorimi i tokës"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Kater mujori I	Detyrim Ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/m të ligjit 72/2012 "Përdorimi i tokës"	JO	Pika 3.1.1 Administrata publike dhe digitalizimi	Strategjia ndërsëktorale "Azhendë Dhehtale e Shqipërisë 2015-2020" Prioriteti Strategjik 3: Krijimi i Infrastrukturas Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore (NSDI).	JO
46	Projektvendim "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Demografia"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Kater mujori II	Detyrim Ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/r të ligjit 72/2012 "Demografia"	JO	Pika 3.1.1 Administrata publike dhe digitalizimi	Strategjia ndërsëktorale "Azhendë Dhehtale e Shqipërisë 2015-2020" Prioriteti Strategjik 3: Krijimi i Infrastrukturas Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore (NSDI).	JO
47	Projektvendim "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Detet"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Kater mujori II	Detyrim Ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/u të ligjit 72/2012 "Detet"	JO	Pika 3.1.1 Administrata publike dhe digitalizimi	Strategjia ndërsëktorale "Azhendë Dhehtale e Shqipërisë 2015-2020" Prioriteti Strategjik 3: Krijimi i Infrastrukturas Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore (NSDI).	JO
48	Projektvendim "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Njësitë Statistike"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Kater mujori II	Detyrim Ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/k të ligjit 72/2012 "Njësitë statistike"	JO	Pika 3.1.1 Administrata publike dhe digitalizimi	Strategjia ndërsëktorale "Azhendë Dhehtale e Shqipërisë 2015-2020" Prioriteti Strategjik 3: Krijimi i Infrastrukturas Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore (NSDI).	JO



49	Projektvendim "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Burimet minerale"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Kater mujori II	Detyrim Ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/z të ligjit 72/2012 "Burimet minerale"	JO	Pika 3.1.1 Administrata publike dhe digitalizimi	Strategjia ndërsëktoriale "Azhendë Dikthiale e Shqipërisë 2015-2020" Prioriteti Strategjik 3: Krijimi i Infrastruktura Komëtare të të Dhenave Gjeo Hapësinore (NSDI).	JO
50	Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Burimet energjetike"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Kater mujori II	Detyrim Ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/y të ligjit 72/2012 "Burimet energjetike"	JO	Pika 3.1.1 Administrata publike dhe digitalizimi	Strategjia ndërsëktoriale "Azhendë Dikthiale e Shqipërisë 2015-2020" Prioriteti Strategjik 3: Krijimi i Infrastruktura Komëtare të të Dhenave Gjeo Hapësinore (NSDI).	JO
51	Projektvendim "Për miratimin e dokumentit "Standardet Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri –Tema: Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare"	Projektvendim	Kryeministri/Zëvendëskryeministri (ASIG)	Kater mujori II	Detyrim Ligjor	Standardet teknike për krijimin e sistemit të informacionit gjeografik për temën e nenit 11/2/nj të ligjit 72/2012 "Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare"	JO	Pika 3.1.1 Administrata publike dhe digitalizimi	Strategjia ndërsëktoriale "Azhendë Dikthiale e Shqipërisë 2015-2020" Prioriteti Strategjik 3: Krijimi i Infrastruktura Komëtare të të Dhenave Gjeo Hapësinore (NSDI).	JO
14	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për disa ndryshime në vendimin nr. 305 datë 23.05.2018, të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërbërjes të anëtarëve të Komisionit Kombëtar kundër Dhunës në Sport".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katër muji I	Duhet përfshirë Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar në Komisionin Kombëtar kundër Dhunës në Sport.	Nevoja e përfshirjes së Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 79/2017 "Për sportin".	Jo	Jo	Jo	Ky projektvendim nuk ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale.
15	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së materialeve dhe të pajisjeve sportive, që përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar dhe procedurat e përjashtimit".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katër muji I	Mungesa e bazës materiale dhe infrastrukturore në sistemin sportiv kombëtar.	Ky projektvendim synon rifreskimin e listës së materialeve sportive që zhdoganohen, duke u përjashtuar nga detyrimet doganore, në funksion të organizatave sportive ekzistuese dhe atyre të reja.	Jo	Kapitulli 3.2 Arsimi, Rinia dhe Sporti	Jo	Ky projektvendim ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Nuk ka efekte sociale.
16	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Forcave të Armatosura si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me status të veçantë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare në Republikën e Shqipërisë".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katër muji I	Detyrim ligjor	Projektvendimi synon të rregullojë çështjen e dhënies së statusit të veçantë për Akademinë e Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë me status të veçantë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.	Jo	Jo	Jo	Nuk ka efekte financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Nuk ka efekte sociale.



17	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për dhënien e statusit të veçantë, Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucion i arsimit të lartë publik në fushën sportit në Republikën e Shqipërisë".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katër mujori I	Detyrim ligjor	Projektvendimi synon të rregullojë çështjen e dhënies së statusit të veçantë për Universitetin e Sporteve të Tiranës, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë me status të veçantë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë.	Jo	Jo	Jo	Nuk ka efekte financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Nuk ka efekte sociale.
18	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për dhënien e statusit të veçantë, Universitetit të Arteve të Tiranës, si institucion i arsimit të lartë publik në fushën artit në Republikën e Shqipërisë".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katër mujori III	Detyrim ligjor	Projektvendimi synon të rregullojë çështjen e dhënies së statusit të veçantë për Universitetin e Arteve të Tiranës, si institucion i vetëm publik i arsimit të lartë me status të veçantë në fushën e artit në Republikën e Shqipërisë.	Jo	Jo	Jo	Nuk ka efekte financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Nuk ka efekte sociale.
19	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e krijimit, organizimit dhe funksionimit të institucionit përgjegjës për rininë".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katër mujori II	Detyrim ligjor	Projektvendimi ka si synim përcaktimin e procedurave të mënyrës së krijimit, organizimit dhe funksionimit të institucionit përgjegjës për rininë.	Jo	Jo	Jo	Ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale.
20	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e anëtarëve si dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Rinisë".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katër mujori II	Detyrim ligjor	Projektvendimi ka si synim përcaktimin e anëtarëve si dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Rinisë.	Jo	Jo	Jo	Nuk ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale.
21	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve që duhet të përmbushë Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore, për t'u njohur si e tillë nga institucioni përgjegjës për rininë".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katër mujori II	Detyrim ligjor	Projektvendimi ka si synim përcaktimin e kriterëve që duhet të përmbushë Organizata Kombëtare Përfaqësuese Rinore, për t'u njohur si e tillë nga institucioni përgjegjës për rininë.	Jo	Jo	Jo	Nuk ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale.
22	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katër mujori II	Detyrim ligjor	Projektvendimi ka si synim përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë.	Jo	Jo	Jo	Ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale.
23	Projektvendim i Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mënyrën e ngritjes, administrimit, mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore".	Projektvendim	Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Katër mujori II	Detyrim ligjor	Projektvendimi ka si synim përcaktimin e rregullave të hollësishme për mënyrën e ngritjes, administrimit, mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore.	Jo	Jo	Jo	Ka efekte ekonomike dhe financiare. Nuk ka efekte mjedisore. Ka efekte sociale.



Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve për vitin 2020

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Nr.	Titulli i projektaktit	Lloji i projektaktit	Ministri propozues	Katër mujori	Arsyet kryesore për propozimin e projektaktit	Çështjet kryesore që parashikohen të rregullojnë projektakti	A është parashikuar projektakti në PKR?	Përputhshmëria e projektaktit me programin politik qeverisës 2017-2021	Lidhja e projektaktit me strategjitë kombëtare dhe sektoriale	Ndikimet e mundshme ekonomike, financiare, sociale dhe mjedisore
							Nëse po, të specifikohet kapitulli përkatës	Nëse përfshihet, të jepet referenca e saktë në program	Nëse lidhet, të specifikohen strategjitë	Përgjigjimi me Po/Jo për ndikimet përkatëse
1	Amendim i Ligjit 8672, datë 26.10.2000, "Për ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të Drejtën e Publikut për të jashtë informacion, për të marrë pjesë në Vendimarrje dhe për t'u Drejtuar Gjykatës për Çështjet e Mjedisit".	Projektligj	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori I	Propozimi i këtij akti ka si qëllim përfshirjen e procesit të informimit dhe tërheqjes së publikut në vendimarrje për Organizmat e Modifikuar Gjenetike.	Përcakton procedurat për informimin të herë më herë dhe efektive dhe pjesëmarrje publike para marrjes së vendimeve nëse duhet të lëshohet ndërmjet fondit të veçantë, me qëllim përbalimin e emergjencave, rehabilitimin dhe zhvillimin e zonat e mbrojtura.	Jo	Po, Pika 2.3, siguria ushqimore.	Po lidhet me Strategjinë e Mjedisit dhe Strategjinë Ndërkulturore për Zhvillimin Rural dhe Ruror 2014-2020.	Po ka ndikim social pasi ndihmon në rritjen e besimit të qytetarëve në vendimarrjen që ndërmarrin institucionet shtetërore.
2	"Për masën e fondit të veçantë për zonat e mbrojtura mjedisore, për burimet e krijimit dhe rregullat e përdorimit të tij".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori I	Krijimi i një fondi të veçantë për ZM-të, nga fondet të siguruar nga të ardhurat dhe nga kontributet e donatorëve - Në të cilin dhe për zbatim të nenit 59 pika 2 e ligjit 81/2017 "Për zonat e mbrojtura".	Administrimin dhe përdorimin e të ardhurave në zonat e mbrojtura ndërmjet fondit të veçantë, me qëllim përbalimin e emergjencave, rehabilitimin dhe zhvillimin e zonat e mbrojtura.	Jo	Po, Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Po, lidhet me SKDH dhe me Dokumentin e Politikave Strategjike të Biodiversitetit.	Projektvendimi ka ndikim ekonomik, financiar dhe social pasi administrimi dhe përdorimi i të ardhurave në zonat e mbrojtura ndërmjet fondit të veçantë, synon përbalimin e emergjencave, rehabilitimin dhe zhvillimin e ZM-ve.
3	"Për përcaktimin e të ardhurave të gjeneruara nga tarifat, masat dhe kriteret e përdorimit të tyre".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori I	Përcaktimi i shërbimeve për masat e ardhurave nga tarifat si dhe përcaktimi i masës dhe kriteret për përdorimin e tyre.	Përcaktimi i tarifave monetare për veprimtaritë e lejuara në Zonat e Mbrojtura.	Jo	Po, Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Po, lidhet me SKDH dhe me Dokumentin e Politikave Strategjike të Biodiversitetit.	Projektvendimi ka ndikim ekonomik dhe financiar pasi lidhet drejtpërdrejt me përcaktimin e tarifave; ndikim social pasi do të zbatohet për të gjitha veprimtaritë brenda Zonave të mbrojtura si dhe mjedisor pasi rrethë e financimit do të rritet investimet përveç në zonat e mbrojtura që do të thotë kontribut për përmirësimin e gjendjes së tyre mjedisore.
4	"Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimin e sipërfaqes dhe paktimit në vëllim nga fondet pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori I	Ky akt ka si qëllim të standartizojë dhe rregullojë procedurat për paraqitjen e kërkesës, dokumentacionin e nevojshëm për rastet e heqjes dhe/ose shtimit të fondit pyjor publik.	Rregullon procesin dhe procedurat në tërësi për subjektet që ushtrojnë aktivitet të ligjshëm mbi fondin pyjor.	Jo	Po, Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Po, lidhet me Dokumentin e Politikave Pyjore në Shqipëri 2019-2030.	Jo projektvendimi nuk ka ndikim.
5	"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.967, datë 25.10.2013, të Këshillit të Ministrave "Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Komitetit të menaxhimit të integruar të mbetjeve".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori I	Ndryshimi i aktit ekzistues ka si qëllim përfshirjen e emertës së institucioneve anëtare të Komitetit të Menaxhimit të Mbetjeve, në funksion të organizimit të ri të ministrave sipas fushave të përgjegjësisë që ato kanë. 2.Parashikimin e ngritjes së dy strukturate mbledhëse të këtij Komiteti gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.	1.Përfshirjen e emertës së institucioneve anëtare të Komitetit të Menaxhimit të Mbetjeve, në funksion të organizimit të ri të ministrave sipas fushave të përgjegjësisë që ato kanë. 2.Parashikimin e ngritjes së dy strukturate mbledhëse të këtij Komiteti gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.	Jo	Po, Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Lidhet me Strategjinë Sektoriale të Mbetjeve.	Projektvendimi nuk ka ndikim ekonomik dhe financiar pasi lidhet me mënyrën e funksionimit të komitetit, me qëllim bashkërendimin e detyrave të ministrave për menaxhim të integruar mjedisor të mbetjeve.
6	"Për përcaktimin e masës së tarifës së përdorimit të faunës së egër, llojit dhe mënyrës e pagimit të saj".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori II	Të plotësojë me akte nënligjore, dhe të risht zbatueshmërinë e ligjit "Për mbrojtjen e faunës së egër", nr. 10006, datë 23.10.2008.	Vendosja e tarifave të përdorimit të llojeve të faunës së egër nga personat fizikë e juridikë. Përcaktimi i kategorive të përdorimit dhe masave respektive të tarifave për çdo kategori dhe i mënyrës të pagimit të saj.	Po (Kapitulli 27)	Po, Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Po, lidhet me SKDH dhe me Dokumentin e Politikave Strategjike të Biodiversitetit.	Projektvendimi ka ndikim ekonomik dhe financiar pasi lidhet me përcaktimin e tarifave që duhet të paguajnë personat fizikë dhe juridikë për përdorimin e llojeve të faunës së egër.
7	"Për rregullat e trajtimit, shfrytëzimit, shites, eksportit (rastet e lejuara), importit, administrimit dhe transportit e materialit drusor dhe prodhimeve jo drusore pyjore, si dhe kategorizimin i rregullave autopajore, përdorimit dhe standardet teknike të tyre.	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori II	Ky akt ka si qëllim të rregullojë dhe standartizojë procedurat e shfrytëzimit të fondit pyjor, trajtimin të tij dhe lëvizjen e mallrave me origjinë nga fondet jashtë territorit të RSH.	Vendos rregulla dhe kriteret për shfrytëzimin, trajtimin dhe lëvizjen e materialit drusor me origjinë nga fondet pyjor, jashtë territorit të RSH.	Jo	Po, Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Po, lidhet me Dokumentin e Politikave Pyjore në Shqipëri 2019-2030.	Jo projektvendimi nuk ka ndikim.
8	"Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e nënprodukteve shtazore, që nuk synohen për t'u konsumuar nga njeriu".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori II	Ky akt ka si qëllim të përcaktojë rregullat për menaxhimin e nënprodukteve të kafshëve që nuk synohen për t'u konsumuar nga njeriu, në mënyrë që të parandalojë dhe minimizojë rrezikun ndaj shëndetit të njeriut dhe kafshëve që vijnë nga këto produkte dhe në veçanti të mbrojtë sigurinë e ushqimit dhe shëndetin ushqimor në vend.	Ky vendim do të zbatohet për nënproduktet kafshëve dhe produktet e përfunduara prej tyre të cilat janë përjashtuar nga konsumi njerëzor.	Jo	Po, Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Lidhet me Strategjinë Sektoriale të Mbetjeve.	Po ka ndikim mjedisor, pasi krijohet një mjedisi me pak i ndotur nga nënproduktet shtazore.
9	"Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr. 641, datë 1.10.2014 "Për miratimin e rregullave për eksportin e mbetjeve dhe kalimin transit të mbetjeve jo të rrezikshme e të mbetjeve inertë".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori II	Ndryshimi i aktit ekzistues lehtëson procedurën për aplikuesit dhe përmirëson cilësinë e shërbimit të ofruar.	Projektakti synon lehtësimin e procedurave për eksportin e mbetjeve.	Po	Po, Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Lidhet me Strategjinë Sektoriale të Mbetjeve.	Jo nuk ka ndikim të asnjë lloji natyre.
10	"Për reduktimin e ndikimit të produkteve plastike në mjedis".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori III	Reduktimi i produkteve plastike i cili ndikon drejtpërdrejt në reduktimin e lëndës në mjedis, në përmirësimin e shëndetit të njeriut si dhe në zhvillimin e turizmit.	Reduktimi i përdorimit të produkteve plastike të cilat janë këthyer në një problem moshor për ndonjë e tokës dhe të ujërave.	Po	Po, Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Lidhet me Strategjinë Sektoriale të Mbetjeve.	Po ka ndikim mjedisor, pasi krijohet një mjedisi me pak i ndotur nga plastika.
11	"Për rregullat, procedurat dhe kriteret për pajisjen me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve.	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori III	Të rregullojë procesin e certifikimit të specialistëve të diplomuar në fushën e pyjeve, me synim pajisjen e subjekteve të interesuar me "drejtues Teknikë".	Rregullon procedurat e pajisjes me certifikatën e ekspertit në fushën e pyjeve.	Jo	Po, Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Po, lidhet me Dokumentin e Politikave Pyjore në Shqipëri 2019-2030.	Jo projektvendimi nuk ka ndikim.
12	"Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 99, Datë 18.02.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve".	Projektvendim	Ministri i Turizmit dhe Mjedisit	Katër mujori III	Të përditësojë katalogun e mbetjeve në përputhje me katalogun evropian të mbetjeve.	Shtimin e kodeve të reja në përputhje me kodet e përcaktuara në katalogun evropian të mbetjeve.	Jo	Po, Pika 2.4, paragrafi i katërt, faqe 12.	Lidhet me Strategjinë Sektoriale të Mbetjeve.	Jo nuk ka ndikim të asnjë lloji natyre.



VENDIM

Nr. 838, datë 24.12.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 607, DATË 27.10.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN E MJEDISEVE TË NDËRTESES ‘GODINA E INOVACIONIT’ NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT (AKSHI)”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3, të vendimit nr. 607, datë 27.10.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjalët “... deri më 31 dhjetor 2019...” zëvendësohen me “... deri më 31 dhjetor 2021 ...”.

2. Ngarkohen Kryeministria, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 844, datë 24.12.2019

PËR KALIMIN NË PRONËSI NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA GJIROKASTËR, TË PRONËS NR. 599, ME EMËRTIM “AERODROM FUSHOR”, ME VENDNDODHJE NË GJIROKASTËR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Gjirokastrë, të pronës nr. 599, me emërtim “Aerodrom fushor”, me vendndodhje në Gjirokastrë, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 599, me emërtim “Aerodrom fushor”, me vendndodhje në Gjirokastrë, sipas planrilevimit, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Gjirokastrë.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Gjirokastrë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



**VENDIM****Nr. 847, datë 24.12.2019****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 343, DATË 8.4.2009,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MËNYRAT DHE PROCEDURAT E
RAPORTIMIT TË AUTORITETEVE
LICENCUESE DHE/OSE
MBIKËQYRËSE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 24, pika 5, e 28, pika 1, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 343, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijojnë:

a) në pikën 1 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

i. pas nënndarjes “iii”, të shkronjës “b”, shtohen nënndarjet “iv” dhe “v”, me këtë përmbajtje:

“iv. shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe fondeve të pensione, si dhe agjentët e tyre;

v. çdo person fizik ose juridik, i cili merret me ofrimin e shërbimeve të mjeteve virtuale.”;

ii. në shkronjën “c”, emërtesa “Ministria e Financave” zëvendësohet me fjalët “ministra përgjegjëse për financat”;

iii. në shkronjën “e” emërtesa “Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit” zëvendësohet me fjalët “ministra përgjegjëse për infrastrukturën”;

iv. nënndarja “ii”, e shkronjës “e”, shfuqizohet;

v. në shkronjën “f” emërtesa “Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” zëvendësohet me fjalët “ministra përgjegjëse për kulturën”;

vi. shkronja “g” ndryshohet si më poshtë vijon:

“g. organet tatimore për organizatat jofitimprurëse.”;

b) pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Autoritetet licencuese dhe/ose mbikëqyrëse mbikëqyrin, nëpërmjet inspektimeve, përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve me detyrimet

e përcaktuara në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.”.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe autoritetet licencuese dhe/ose mbikëqyrëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM**Nr. 848, datë 24.12.2019****PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE ME SHKËMBIM
LETRASH TË MARRËVESHJES SË
GRANTIT NR. TF013972, NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM/
SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR
ZHVILLIM, QË VEPRON SI
ADMINISTRATORE E FONDEVE
GRANT TË SIGURUARA NGA
DHURUES TË NDRYSHËM, NËN
FONDIN E DYTË TË BESIMIT
SHUMËDHURUES PËR SHQIPËRINË,
PËR MBËSHTETJEN PËR NGRITJEN E
KAPACITETEVE PËR ZBATIMIN E
SISTEMIT TË PLANIFIKIMIT TË
INTEGRUAR (SPI) 2, MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 243, DATË 3.4.2013, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së grantit nr. TF013972, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim, që vepron si administratore e fondeve grant të



siguruara nga dhurues të ndryshëm, nën Fondin e Dytë të Besimit Shumëdhurues për Shqipërinë, për mbështetjen për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) 2, miratuar me vendimin nr. 243, datë 3.4.2013, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

BANKA BOTËRORE

BNRZH-IDA
GRUPI I BANKËS
BOTËRORE

WORLD BANK
GROUP OFFICE
PRASTERSTRASSE
31/21
Vienna, Austria, 1020

LINDA VAN GELDER

Drejtoresha Rajonale, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

27 qershor 2019

Shkëlqesisë së saj, Anila Denaj
Ministër
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3
Tiranë,
Shqipëri

E nderuar znj. Ministre,

Shqipëri: Mbështetje për ngritjen e kapaciteteve për zbatimin e sistemit të planifikimit të integruar (SPI) 2
Granti nr. TF013972 dhe granti nr. TF0A8666
Ndryshimi i marrëveshjes së grantit dhe letërmarrëveshjes

I referohemi marrëveshjes së grantit (TF013972), të datës 7 mars 2013, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (“Marrësi”) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/ Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (“Banka Botërore”), e ndryshuar; dhe letërmarrëveshjes (TF0A8666), të datës 30 tetor 2018, ndërmjet marrësit dhe Bankës Botërore, që vepron si administratore e fondeve të grantit të siguruar nga dhurues të ndryshëm (Dhurues) nën Fondin e Besimit Shumëdhurues për mbështetje në ngritjen

e kapaciteteve për zbatimin e Sistemit të Planifikimit të Integruar 2 (SPI) 2. I referohemi dhe shkresës suaj me nr. prot. 3423/3, e datës 9 prill 2019, ku i kërkon Bankës Botërore të shtyjë datën e disbursimit të fondeve për grantet e përmendura më sipër, sipas marrëveshjes së grantit dhe letërmarrëveshjes përkatëse.

Kemi kënaqësinë t’ju informojmë se Banka Botërore pajtohet me kërkesën tuaj dhe për këtë arsye ka vendosur 30 qershorin 2020, si datën e fundit për qëllimet e seksionit 3.03, të aneksit të marrëveshjes së grantit dhe letërmarrëveshjes përkatëse.

Të gjithë termat dhe kushtet e tjerë të të dyja marrëveshjeve, me përjashtim sa është ndryshuar këtu, mbeten në fuqi dhe në efekt të plotë.

Sinqerisht,
(nënshkrimi)

Linda Van Gelder
Drejtoresha Rajonale, Ballkani Perëndimor
Rajoni i Evropës dhe Azisë Qendrore

cc: Z. Patrizio Pagano, Drejtor Ekzekutiv,
Banka Botërore
Tel.: +43 (1) 2170 782
Faks: +43 (1) 2170 701

VENDIM
Nr. 851, datë 24.12.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 387, DATË 25.5.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘PËRMIRËSIMI I SHITESAVE RRUGORE FUSHË-KRUJË–THUMANË’”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 99/2018,



“Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 387, datë 25.5.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 3, nënndarja “- tokë ‘arë’ dhe ‘truall’ me sipërfaqe 12 648 m², me vlerë 5 409 102 (pesë milionë e katërqind e nëntë mijë e njëqind e dy) lekë zëvendësohet me “- tokë ‘arë’ dhe ‘truall’ me sipërfaqe 11 745 m² me vlerë 5 180 643 (pesë milionë e njëqind e tetëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e tre) lekë.

b) Në pikat 3 dhe 4, vlera “... 16 686 204 (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e katër) lekë ...” zëvendësohet me “... 16 457 745 (gjashtëmbëdhjetë milionë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e dyzet e pesë) lekë ...”.

c) Në tabelën bashkëlidhur vendimit, nënndarjet me numra rendorë 5, 6, 7, 8 dhe 9, ndryshohen dhe në fund të tabelës shtohen nënndarjet me numra rendorë 42, 43 dhe 44, përkatësisht, sipas tabelave “B” dhe “A” që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Shpenzimet procedurale, me vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të tij.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE TË TË CILËVE SHPRONËSOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTTIT, PËR SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 387, DATË 22.5.2016, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT ‘PËRMIRËSIMI I SHITRESAVE RRUGORE FUSHË-KRUJË-THUMANË’”.

Tabela A, që pasqyron pasuritë e shtuara

Tabela A

Nr. rendor në VKM	Pronari			Të dhënat (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				Shpronësimet tokë “arë”			Vlera totale	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Z.K	Nr. pas.	Lloji i pas.	Sip. Totale	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
42	GJOK	ZEF	MUSTEQJA	2537	68/50	Are	4391	571	253	144463	144,463	Konfirmuar nga ASHK-ja
43	BRIKENA	NUE	SHIJAKU	2537	68/46	Are	2504	169	253	42757	42,757	Konfirmuar nga ASHK-ja
44	AGETINA	NUE	ÇURO (MUSTEQJA)	2537	68/48	Are	2595	69	253	17457	17,457	Konfirmuar nga ASHK-ja
SHUMA								809		204,677	204,677	

Tabela B, që pasqyron ndryshimet e bëra në tabelën bashkëlidhur VKM-së nr. 387, datë 25.5.2016

Nr. rendor në VKM	Pronari			Të dhënat (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				Sipërfaqet që ndryshojnë				Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri					Shpronësimet tokë “arë”			Vlera totale	
				ZK	Nr. pas.	Lloji i pas.	Sip. totale	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
5	ELIDA	NUE	SHKRETA (MUSTEQJA)	2537	68/44	Are	2489	317	253	80201	80,201	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	GLADIOLA	NUE	MUSTEQJA	2537	68/42	Are	2439	417	253	105501	105,501	Konfirmuar nga ASHK-ja
7	LEONORA	NUE	LLESHI (MUSTEQJA)	2537	68/40	Are	2399	409	253	103477	103,477	Konfirmuar nga ASHK-ja
8	LEONORA	NUE	LLESHI (MUSTEQJA)	2537	68/38	Are	2279	377	253	95381	95,381	Konfirmuar nga ASHK-ja
9	MARIE	ZEF	MUSTEQJA	2537	68/36	Are	2212	25	253	6325	6,325	Konfirmuar nga ASHK-ja
SHUMA								1545	253		390,885	

Shënim.

1. Për tokën “arë”, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.

**VENDIM****Nr. 852, datë 24.12.2019****PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË SHOQËRISË
ALBGAZ SHA, TË PASURIVE ME
NR. 181/80 DHE NR. 181/81, ZONA
KADASTRALE 2631, KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të shoqërisë Albgaz sh.a., të pasurive me nr. 181/80 dhe nr. 181/81, zona kadastrale 2631, me

sipërfaqe përkatësisht 448,7 m² dhe 25,551.30 m², sipas planeve të rilevimit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Pasuritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimit, do të përdoren për ndërtimin e Qendrës së Mirëmbajtjes Korçë.

3. Shoqërisë Albgaz sh.a. i ndalohet t’i tjetërsojë apo t’ua japë në përdorim të tretëve pasuritë e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria Albgaz sh.a. dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



PLAN RILEVIMI

PËRGATITI

INXH.GJEODET ERION LAMI

LIÇENCË: T.1111/1 DATE: 29.05.2017

DATA E PËRGATITJES: 24.10.2019



VULA/FIRMA

IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE NR: 2631
 NR.PASURISË: 181/81 VOL: 28 FQ: 214
 INDEKSI I HARTËS: K - 34 - 126 (58-A)
 SHKALLA: 1:1500
 ADRESA E PASURISË: RRETHI KORÇË Q/F. MBORJE
 LLOJI I PASURISË: TRUALL
 PRONARI/ËT: SHTET

KUFITARËT:


VERI: Nr.Pas. 600
 JUG : Nr.Pas. 426; 181/20
 LINDJE: Nr.Pas. 600
 PERËNDIM: Nr.Pas. 426

Porositës/ Emri Mbiemri
 "ALBGAZ" S.H.A

PLANI I RILEVIMIT ËSHTË HARTUAR REFERUAR DOKUMENTAVE HIPOTEKORË (KARTELË E PASURISË SË PALUAJTSHME DHE FRAGMENTIT TË HARTËS TREGUESE, TË RIFRESKUAR ME DATË 15.10.2019)

SI PËRFAQIA TOTALE E PASURISË ME NR.PASURIE: 181/81 = 25.551.30 m²

SI PËRFAQIA TOTALE E NDËRTESAVE BRËNDË TRUALLIT ME NR.PASURIE: 181/81 = 1.841.30 m²





PLAN RILEVIMI

PËRGATITI

INXH.GJEODET ERION LAMI

LIQENCË: T.1111/1 DATE: 29.05.2017

DATA E PËRGATITJES: 24.10.2019



VULA/FIRMA

IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE NR: 2631
 NR.PASURISË: 181/80 VOL: 28 FQ: 213
 INDEKSI I HARTËS: K - 34 - 126 (58-A)
 SHKALLA: 1:1500
 ADRESA E PASURISË: RRETHI KORÇË Q/IF: MBORJE
 LLOJI I PASURISË: TRUALL
 PRONARIËT: ALBINIERA S.H.A

KUFITARËT:

VERI: Nr.Pas. 181/81
 JUG : Nr.Pas. 181/81
 LINDJE: Nr.Pas. 181/81
 PERËNDIM: Nr.Pas. 181/81

Porositës/ Emri.Mbledhri
 "ALBGAZ" S.H.A

PLANI I RILEVIMIT ËSHTË HARTUAR REFERUAR DOKUMENTAVE HIPOTEKORË (KARTELË E PASURISË SË PALUAJTSHME DHE FRAGMENTIT TË HARTËS TREGUESE, TË RIFRESKUAR ME DATË 10.10.2019)

SI PËRFAQJA TOTALE E PASURISË ME NR.PASURIE: 181/80 = 448.70 m²
 SI PËRFAQJA TOTALE E NDËRTESES BRËNDË TRUALLIT ME NR.PASURIE: 181/80 = 448.70 m²





transmet nga V.K.M. Nr. 519, Datë 7.11.1993

A-SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TË PASURISË

Zona Kadastrale : 2831 NR. I PASURISË : 05654 Vol. 28, Fq. 213
 Indeks i Hartës : 11-39-126-158-A3 Vizionet : Vol. 28, Fq. 213
 Adresa e pasurisë : Rrethi PRISHTINE Q.F. MOJAKET derisht Vol. 28, Fq. 213
 REF. 05654 PG 05654 Sh. 05654 K. 05654 Ap. 05654

B-SEKSIONI I PËRSHKRIMIT TË PASURISË

Lloji i Pasurisë : TRUAJE Brendi V.K.N. Jo 05654 Ref. 05654

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Totale: sa Ndërrës	Per pjesen e përbashkët:
1. <u>448.2</u> m ²	1. <u>448.2</u> m ²	1. <u>448.2</u> m ²	Per pjesen e përbashkët:
Ref. <u>05654</u>	Ref. <u>05654</u>	Ref. <u>05654</u>	<u>PALLATI</u>
2. <u> </u> m ²	2. <u> </u> m ²	2. <u> </u> m ²	Kuota e Pjesëmarrjes:
Ref. <u> </u>	Ref. <u> </u>	Ref. <u> </u>	<u> </u> %
3. <u> </u> m ²	3. <u> </u> m ²	3. <u> </u> m ²	Nr. i Pasurisë (Pallati):
Ref. <u> </u>	Ref. <u> </u>	Ref. <u> </u>	<u> </u>
4. <u> </u> m ²	4. <u> </u> m ²	4. <u> </u> m ²	Vol. <u> </u> Fq. <u> </u>
Ref. <u> </u>	Ref. <u> </u>	Ref. <u> </u>	

C-SEKSIONI I PRONËSISË

Nr. Dok	Data Registrim	Emri Atësis Mbiemri	Nr. Pasap.	IFBI	Adresa e Pronant	Shënime paguar	Data e fsh. Certifikates	Shënime	Forma
<u>05654-28-05-2018</u>	<u>28-05-2018</u>	<u>SHIET</u>		<u>1</u>				<u>0.2</u>	
<u>05654-28-05-2018</u>	<u>28-05-2018</u>	<u>ALBMINERA SHK</u>		<u>1</u>			<u>28-05-2018</u>	<u>0.2</u>	<u>1/2</u>



D- SEKSIONI I SERVITURAVE DHË INTERESAVE TË TJERA

Nr. Dok	Data Registrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e lësh të Çertifikatës
12575	10.04.2017	servituti	Me vendim të K.K.K. Prizreni nr. 310/17, 13.03.2017 të dhënë të dytën e parashtrimit për objektet shpirtërore të muzeut gjyqësor "Xhami - Drenova", të ndodhura në sipërfaqen e llogarit prej 6000m ² të shpirtërore të shpirtërore Halid Shaban Papa me përshkrimin si më poshtë: Myqerem Papa, Lumburi Papa, Gerdëna Papa, Shpresa Papa, Sejdiç Papa, Gëzgjësi, Fardes Papa, Drita Papa, Suzana Papa, Fatmirë Papa, Nafise Papa, Lenta Katiçe, Sejdiç 1/30 pjesë.	

E- SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TË GJYKATËS, KUFIZIME

Sr. Dok	Data Registrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e lësh të Çertifikatës



Miruar nga V. K. M. Nr. 519, Date 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol 28 Fq. 214

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zona Kadastrale: 2631 NR. i PASURISE: 181/81 --> Vijon nga Vol 11 Fq. 208

Indeksi i Hartes: K-34-126-58-A Vijon në: Vol , Fq. deri në: Vol , Fq. -->

Adresa e Pasurisë: Rrethi KORÇË Q/F MBORJE

PERFUNDIMTARE (deja):

Rr/L P/G SH K Ap

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: TRUALL Brenda V.K.N. : PO , Ref. PL

**RREGULL
UES**

Sip. Totale e Pasurisë:	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndërtesi
1. 25,551.30 m ² Ref. 00005654	1. 25,551.30 m ² Ref. 00005654	1. 1,841.30 m ² Ref. 00005654
2. m ² Ref.	2. m ² Ref.	2. m ² Ref.
3. m ² Ref.	3. m ² Ref.	3. m ² Ref.
4. m ² Ref.	4. m ² Ref.	4. m ² Ref.

Per pjesen e përbashkët:

PALLAT

Kuota e pjesmarrjes: %

Nr i Pasurise (pallat):

Vol Fq.

Pershkrim i veçantë:

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr. Dok	Data Regjistrimit	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikates	Shënime	Firma
00005654	19/09/2018	SHTET				1	-			T.Nd pasurie	

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqësues i familjes; B - bashkëpronar (%)



**D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE,
SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA**

Nr. Dek	Data Regjistrimit	Tipi	Pershkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
20302/24-51	10/12/2017	15_AV	ME VENDIMIN E K.K. PRONAVE NR.31 DT 13.02.2007 TE NJOHE TE DREJTEN E PARABLERJES PER OBJEKTET SHTETERORE TE MINIERES QYMYR-GURI MBORJE DRENOVE TE NDODHURA MBI SIPWTERAQEN E TRUALLIT PREJ N6000 M2 TE SUBJEKTIT TE SHPRONESUAR HALIT SHABAN FUPANE PERSONAT QE PERFITOINE SI MEPOSHTTE: NYQIEREM PUPA, LONTURI PUPA, GERALDINA PUPA, SHPRESA PUPA, FERDES PUPA, Drita PUPA, SUZANA PUPA, FATMIRA PUPA, NEFISE PUPA, LORETA QATIPi 1/30 PJESE			

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QËNDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME KORO
Adresa: Rruga 11 Nentori, Legji, Brigada 17 S (prane Prefektures)

Adresa: Rruga 11 Nentori, Lzgj. Brigada 17 S (prane Prefektures)

KORÇË, me 15 / 10 / 2019

SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone

Në regjistrin Vo! 28, Faqe 214, Zona Kadastrale 2631, Qyteti Korçë



**VENDIM****Nr. 853, datë 24.12.2019**

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 327, DATË 27.4.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 110 kv, RRASHBULL–GOLEM–KAVAJË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 327, datë 27.4.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 3, vlera nga 967 956.8 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e

pesëdhjetë e gjashtë pikë tetë) lekë, ndryshohet në 957 814.52 (nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e katërmëdhjetë pikë pesëdhjetë e dy) lekë.

b) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Vlera e përgjithshme e kompensimit dhe vlera e shpenzimeve për botimin në gazetë të përballohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., si subjekti kërkues i këtij shpronësimi, ndërsa shpenzimet procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga fondet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.”.

c) Nënndarjet me nr. rendorë 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43 dhe 44, ndryshohen sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a. dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kavajë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama**

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE PREKEN NGA DISA SHITESA DHE NDYSHIME NË VENDIMIN NR. 327, DATË 27.4.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 110 kv RRASHBULL–GOLEM–KAVAJË”

Nr. rendor në VKM-në nr. 327, datë 27.4.2016	Numri i shtyllës	Lloji i pasurisë	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. i pasurisë	Zona kadastrale	Sip. e shpronësimit për shtyllë (m ²) sipas VKM-së nr. 327, datë 27.4.2016	Çmimi lekë/m ²	Vlera e shpronësimit në lekë për shtyllë
FSHATI SEFERAJ										
36	36	Arë	Bashkëpronësi Familja Ajazi			503/1	3271	58.32	329	19,188.52
FSHATI TILAJ										
37	37	Arë	Bashkëpronësi Familja Shahu			423/2, 423/3	3600	77.33	329	25,443.03
38	38	Arë	Bashkëpronësi Familja Tila			425/46	3600	47.33	329	15,573.02
FSHATI SEFERAJ										
39	39	Arë	Avni		Belba	508/20	3271	112.36	329	36,966.44
40	40	Arë	Bashkëpronësi Familja Çelçica			525/49	3271	112.36	329	36,966.44
41	41	Arë	Altin	Halil	Begëja	359/25	3271	40.56	329	13,344.24
42	31 A	Arë	Bashkëpronësi Familja Ajazi			358/8	3271	73.96	329	24,332.84
43	42	Arë	Bashkëpronësi Familja Çopa			357/8	3271	77.33	329	25,441.57
44	43	Arë	Bashkëpronësi Familja Ajazi			356/10	3271	34.33	329	11,294.57
Sipërfaqe totale për shpronësim (m²)								633.89		
Shuma totale në lekë për shpronësim								208,550.67		



VENDIM

Nr. 854, datë 24.12.2019

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 666, DATË 10.10.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT
NË MENSA E KONVIKTE DHE
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR
PËRFITIMIN E BURSIVE E TË
PAGESAVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR NË
INSTITUCIONET ARSIMORE
PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 19, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme, familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, të nenit 6, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të nenit 12, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Pas pikës 10, shtohet pika 10.1, me këtë përmbajtje:

“10.1 Bursat e nxënësve për vitin e dytë e lart rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga këshilli bashkiak, sipas vendndodhjes territoriale e administrative të shkollave profesionale apo konvikteve ku janë vendosur nxënësit, përfitues të bursës/kuotës ushqimore, sipas planit të bursave të miratuara në vitin paraardhës nga këshilli bashkiak i njëjtit të vetëqeverisjes vendore.”.

b) Pas pikës 14, shtohet pika 14.1, me këtë përmbajtje:

“14.1 Vetëm për vitin shkollor 2019–2020, njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet tu dërgojnë zyrtarisht, jo më vonë se muaji janar i vitit 2020, drejtorive të shkollave të arsimit profesional dhe zyrave vendore të arsimit parauniversitar, vendimet për dhënie e bursave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.”.

c) Fjala e parë e pikës 31.1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“31.1 Përfitojnë bursë në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, anëtarë të familjes së personave që kanë humbur jetën ose janë shpallur të zhdukur në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si dhe ofruesit e arsimit të mesëm profesional publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 855, datë 24.12.2019****PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E BRENDSHËM TË
ARKIVIT ELEKTRONIK TË AKTEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 15, ligjit nr. 78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Arkivit Elektronik të Akteve, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Qendra e Botimeve Zyrtare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

RREGULLORE**PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E BRENDSHËM TË
ARKIVIT ELEKTRONIK TË AKTEVE****I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i të drejtave, detyrave dhe përgjegjësisë të punonjësve të Qendrës së Botimeve Zyrtare, për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të proceseve të punës në Arkivin Elektronik të Akteve, për botimin e akteve të Fletores Zyrtare dhe të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare, në formatin elektronik.

2. Objekti i kësaj rregulloreje është garantimi i transparencës së administratës shtetërore, ofrimi i informacionit legjislativ në formatin elektronik, duke pasur akses të plotë nga publiku, si dhe garantimin e mirëfunksionimit të Arkivit Elektronik të Akteve, në funksion të bërjes së mundur të hyrjes në fuqi të akteve të botueshme,

sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për botimin e akteve të botueshme.

3. Qëllimi i Arkivit Elektronik të Akteve është regjistrimi, editimi, publikimi, përditësimi, ruajtja, administrimi dhe aksesimi i të gjitha akteve të botueshme, në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar, politikat kombëtare dhe praktikën më të mira në këtë drejtim.

4. Arkivi Elektronik i Akteve ka këto objektiva kryesore:

a) aksesim të shpejtë të statusit aktual të legjislacionit;

b) sigurimin e legjislacionit të konsoliduar;

c) marrëdhënie transparente dhe efektive midis dokumenteve dhe enteve që marrin pjesë në proces;

ç) gjenerimin e standardizuar dhe efektiv të informacionit në të gjitha fazat e tij;

d) versionimi dhe aksesim i lehtë i versioneve të dokumenteve;

dh) kërkimin e shpejtë dhe efektiv të akteve ligjore;

e) automatizimin e proceseve, krijimin, kontrollin dhe aprovimin e dokumenteve ligjore;

ë) publikim;

f) ruajtje, arkivim dhe ripërdorim të informacionit.

5. Arkivi Elektronik i Akteve është databaza elektronike e përcaktuar nga ligji nr. 78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, i ngritur mbi një sistem menaxhimi dokumentesh, i cili përmban:

a) Fletoren Zyrtare, në versionin elektronik;

b) aktet e botueshme;

c) aktet e përditësuar;

ç) Kode të Republikës së Shqipërisë;

d) përmbledhëset e legjislacionit.

6. Arkivi Elektronik i Akteve, sipas mënyrës së organizimit dhe të infrastrukturës, garanton:

a) lidhjen e aktit që regjistrohet me aktin apo aktet ku mbështetet baza ligjore;

b) lidhjen e aktit që regjistrohet me aktin apo aktet ku ai vepron, duke gjeneruar në mënyrë automatike listën e akteve të cilat duhen përditësuar dhe statusin e aktit apo të akteve që ai ndryshon ose shfuqizon;

c) një ndërfaqe për përditësimin e akteve në të cilën integrohen funksione edituese, sipas aplikacionit *microsoft word*;



ç) ndërtimin e proceseve të punës sipas nevojave të Qendrës së Botimeve Zyrtare në formën e “*workflows*”;

d) krijimin e roleve të përdoruesve sipas proceseve të punës në Qendrën e Botimeve Zyrtare;

dh) mundësinë e konsultimit të akteve të përditësuara;

e) sigurimin e gjurmimit të veprimeve të kryera nga përdoruesit e Arkivit Elektronik të Akteve;

ë) gjenerimin e raporteve të ndryshme për qëllime statistikore;

f) ndërtimin e modelit të të dhënave në përputhje të plotë me standardin *European Legislation Identifier* (ELI).

7. Aktet dhe fletoret zyrtare publikohen elektronikisht, sipas standardit të unifikuar të Bashkimit Evropian për publikimin e akteve ligjore “ELP”.

8. Faqja përmban informacion të përditësuar për legjislacionin e botueshëm shqiptar të publikuar nga Qendra e Botimeve Zyrtare. Informacioni i publikuar në Arkivin Elektronik të Akteve është i aksesueshëm nga publiku i gjerë pa asnjë lloj kufizimi. Faqja *web* aksesohet në gjuhën shqipe dhe atë angleze.

9. Informacioni i publikuar është i organizuar në kategoritë kryesore të pozicionuara në të majtë të faqes *web*, në mënyrë të përmbledhur janë:

a) Fletore Zyrtare të publikuara, të organizuara sipas viteve në rend zbritës dhe brenda vitit, sipas muajve;

b) Buletini i Njoftimeve Zyrtare i publikuar, i organizuar sipas viteve, në rend zbritës dhe brenda vitit, sipas muajve;

c) Arkivi Elektronik i Akteve paraqet aktet të organizuara e grupuara sipas llojit të aktit;

ç) Kushtetuta;

d) kodet;

dh) përmbledhjet e legjislacionit;

e) treguesit kronologjik;

ë) kërkimi i informacionit në faqen *web*.

10. Në rubrikën “Fletore Zyrtare” publikohen aktet e botueshme në versionin përfundimtar në formatin elektronik. Fletoret zyrtare të publikuara organizohen sipas viteve në rend zbritës dhe brenda vitit, sipas muajve. Rubrika përditësohet sa herë që publikohen Fletore Zyrtare të reja.

11. Në rubrikën “Buletini i Njoftimeve Zyrtare” publikohen të gjitha njoftimet e institucioneve

shtetërore, me qëllim bërjen e tyre publike, të organizuara sipas viteve.

12. Në rubrikën “Arkivi Elektronik i Akteve” gjenden të gjitha aktet e botuara sipas legjislacionit në fuqi, në formatin elektronik, të cilat organizohen sipas llojit të akteve dhe numrit total të akteve të publikuara.

13. Në rubrikën “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” pasqyrohen të gjitha ndryshimet që ka pësuar akti fillestar dhe përmban variantin në fuqi të tij.

14. Në rubrikën “Kode të Republikës së Shqipërisë” pasqyrohen variantet e fundit të përditësuara të tyre.

15. Në rubrikën “Përmbledhëset e legjislacionit” grupohen aktet juridike që rregullojnë fusha të caktuara të së drejtës.

16. Në rubrikën “Treguesit kronologjikë” pasqyrohen në mënyrë kronologjike të gjitha aktet juridike të botuara në fletoret zyrtare ndër vite.

17. Çdo akt i paraqitur në formatin elektronik përmban informacion mbi të dhënat bazë të tij:

a) Fletoren Zyrtare ku është botuar;

b) bazën ligjore të aktit;

c) lidhjen e aktit me aktet e tjera;

ç) versionet e përditësimeve.

II. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I PROCESVEVE TË PUNËS SË ARKIVIT ELEKTRONIK TË AKTEVE

1. Organizimi i brendshëm i proceseve të punës për Arkivin Elektronik të Akteve i referohet proceseve të administrimit të aktit, Fletores Zyrtare, Njoftimeve, Buletinit të Njoftimeve Zyrtare dhe të konsolidimit e të përditësimit të marrëdhënies së akteve.

2. Tërësia e informacionit për rolet, proceset dhe dokumentet organizohet në formën e një *collaboration site* (ambient i përbashkët bashkëpunimi) i cili mundëson integrim të plotë të proceseve të informacionit dhe të roleve të përdoruesve. Përdoruesit aksesojnë *collaboration site* nëpërmjet kredencialeve të vendosura në dispozicion nga administratori i Arkivit Elektronik të Akteve. Arkivi Elektronik i Akteve integrohet në *Active Directory*, pjesë e rrjetit GOV dhe çdo përdorues i tij është pjesë e njësisë organizative të Qendrës së Botimeve Zyrtare.

3. Secilit rol në Arkivin Elektronik të Akteve i caktohet përdoruesi ose grupi i përdoruesve. Secili përdorues pajiset me të dhënat hyrëse në Arkivin



Elektronik të Akteve dhe gjen të organizuar detyrat sipas statusit respektiv “aktive” dhe të “përfunduara”.

4. Administrimi ndahet në procese dhe përdorues në përputhje me rolet e përcaktuara për çdo proces pune. Në çdo rast, përdoruesi që ka të drejtë të fillojë një proces pune për zgjedh një nga proceset e listuar:

- a) procesi i aktit;
- b) procesi i Fletores Zyrtare;
- c) procesi i Njoftimeve Zyrtare;
- ç) procesi i Buletinit të Njoftimeve Zyrtare.

5. Përdoruesve të Arkivit Elektronik të Akteve u caktohen një ose më shumë role dhe anasjelltas, si më poshtë vijon:

- a) titullar;
- b) operator;
- c) kryeredaktor;
- ç) përgjegjës i Fletores Zyrtare;
- d) redaktor i Fletores Zyrtare;
- dh) korrektor i Fletores Zyrtare;
- e) operator;
- ë) përgjegjës i Buletinit të Njoftimeve Zyrtare;
- f) operator;
- g) përgjegjës i Arkivit Elektronik;
- gj) korrektor i Buletinit të Njoftimeve Zyrtare;
- h) operator;
- i) redaktor ligjor i Arkivit Elektronik;
- j) administrator.

6. Shpërndarja e kredencialeve përkatëse të punonjësve, sipas rolit dhe funksioneve në Arkivin Elektronik të Akteve, bëhet me urdhër të titullarit të Qendrës së Botimeve Zyrtare.

7. Procesi i administrimit të aktit në Arkivin Elektronik të Akteve fillon me regjistrimin e aktit nga operatori dhe kalon fazat e përgatitjes deri në aprovimin përfundimtar nga përgjegjësi i Fletores Zyrtare. Pas protokollimit, akti kalon për konfirmim te titullari. Akti duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- a) lloji i aktit;
- b) numër akti;
- c) datë akti;
- ç) tipi i aktit;
- d) numri dhe data e protokollit të aktit të Qendrës së Botimeve Zyrtare;
- dh) institucioni përgjegjës;
- e) institucioni propozues;
- ë) titulli i aktit;

f) fusha e veprimtarisë;

g) dekretuar.

8. Aktet e konfirmuara nga titullari kalojnë te kryeredaktori, i cili pasi konfirmon aktin e ngarkon atë në formatin *word*. Akti kalon tek operatori i sektorit të Fletores Zyrtare për vijimin e editimit në të njëjtin format.

9. Akti i redaktuar nga operatorët e sektorit të Fletores Zyrtare kalon për konfirmim te korrektori, i cili pas korrigjimit konfirmon detyrën në lidhje me aktin dhe akti kalon si detyrë aktive pranë redaktorit.

10. Redaktori shkarkon versionin final të korrigjuar në *word* dhe kryen konfrontimin e aktit. Pas konfrontimit, akti kalon si detyrë aktive për përgjegjësin e Fletores Zyrtare, i cili pasi verifikon saktësinë e të dhënave, konfirmon aktet, të cilat kalojnë në statusin “përfunduar”.

11. Procesi i administrimit të Fletores Zyrtare në Arkivin Elektronik të Akteve iniciohet nga kryeredaktori, i cili krijon Fletoren Zyrtare dhe përcakton të dhënat që lidhen me numrin, datën, kapakun përkatës dhe aktet përbërëse të cilat janë të detyrueshme për krijimin dhe janë të editueshme deri në konfirmimin final të saj.

12. Pas konfirmimit të Fletores Zyrtare nga kryeredaktori, kalon në proces pune për përgjegjësin e Fletores Zyrtare, i cili pasi konfirmon Fletoren Zyrtare, kalon për formatim tek operatori, i cili bashkon aktet dhe i formaton ato në format *word* të vetëm.

13. Përgjegjësi i Fletores Zyrtare kontrollon Fletoren Zyrtare të përfunduar nga operatori dhe e konfirmon ose e kthen prapa nëse ka nevojë për modifikime. Pas konfirmimit, Fletorja Zyrtare përcillet për miratim përfundimtar te kryeredaktori.

14. Përpara miratimit përfundimtar të Fletores Zyrtare, kryeredaktori përditëson dhe editon informacionin bazë dhe e konfirmon plotësisht atë. Kryeredaktori akseson versionin *word* dhe *PDF* të Fletores Zyrtare. Konfirmimi përfundimtar i Fletores Zyrtare mundëson publikimin automatik në faqen *web* të Fletores Zyrtare.

15. Procesi i administrimit të Njoftimit Zyrtar në Arkivin Elektronik të Akteve iniciohet dhe krijohet nga operatori dhe i kalon titullarit për konfirmim. Pas dhënies së konfirmimit nga ana e titullarit, njoftimi kalon te kryeredaktori.

16. Aktet e konfirmuara nga kryeredaktori, të cilat bëhen pjesë e Buletinit të Njoftimeve Zyrtare,



kalojnë për editim te sektori i Buletinit të Njoftimeve Zyrtare.

17. Editori, pasi përfundon me editimin dhe versionimin e njoftimit, e mbyll procesin dhe e kalon njoftimin në statusin “edituar”.

18. Njoftimi i edituar i kalon korrektorit, i cili korrekton njoftimin e edituar, versionon dhe më pas mbyll procesin duke e kaluar njoftimin në statusin “korrektuar”.

19. Njoftimi i korrektuar i kalon redaktorit, i cili konfronton njoftimin e korrektuar, versionon dhe më pas mbyll procesin, duke e kaluar aktin në statusin “konfrontuar”.

20. Njoftimi i konfrontuar paraqitet si detyrë aktive për përgjegjësin e Buletinit të Njoftimeve Zyrtare, i cili konfirmon njoftimin dhe e kalon aktin në statusin “përfunduar”.

21. Procesi i administrimit të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare në Arkivin Elektronik të Akteve inicohet dhe krijohet nga kryeredaktori, i cili përcakton numrin, datën dhe njoftimet përbërëse. Me krijimin e tij nga kryeredaktori, Buletini i Njoftimeve kalon në statusin “në proces”.

22. Përgjegjësi i Buletinit të Njoftimeve Zyrtare miraton detyrën aktive për të gjitha proceset e punës të konfirmuara nga kryeredaktori. Pas dhënies së miratimit, njoftimi kalon për formatim tek operatori. Buletini i formatuar e versionuar nga operatori përcillet për miratim përfundimtar te përgjegjësi i Buletinit të Njoftimeve Zyrtare.

23. Përgjegjësi i Buletinit të Njoftimeve Zyrtare kontrollon Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të përfunduar nga operatori dhe e konfirmon ose e kthen prapa (nëse ka nevojë për modifikime). Përgjegjësi, pas konfirmimit të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare, e përcjell për miratim përfundimtar te kryeredaktori, i cili përditëson informacionin bazë dhe e konfirmon plotësisht atë.

24. Konfirmimi përfundimtar i Buletinit të Njoftimit Zyrtar nga kryeredaktori mundëson publikimin automatik në faqen *web* të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare.

III. FUNKSIONIMI I ARKIVIT ELEKTRONIK TË AKTEVE

1. Arkivi Elektronik i Akteve funksionon si një sistem menaxhues i dokumenteve që ngarkohen në të, duke siguruar ruajtjen e tyre në disa formate, përdorimin dhe aksesimin e tyre.

2. Arkivi Elektronik i Akteve bën të mundur përditësimin dhe konsolidimin e të gjitha akteve të publikuara elektronikisht në faqen *web*.

3. Përditësimi i marrëdhënies së aktit me aktet e tjera realizohet nga operatori i Arkivit Elektronik, duke përzgjedhur aktet në varësi të marrëdhënies së tij me aktet e tjera, duke pasur lidhje të tipit “bazohet”, “ndryshon”, “shfuqizon” dhe “korrigjon”. Pasi operatori përfundon detyrën, e kalon për konfirmim te përgjegjësi i Arkivit Elektronik, për të vijuar me publikimin automatikisht në faqen *web*.

4. Procesi i konsolidimit të aktit rrjedh nga përditësimi i tij dhe kryhet nga redaktori i Arkivit Elektronik. Në varësi të marrëdhënieve të aktit me aktet e tjera Arkivi Elektronik i Akteve gjeneron automatikisht detyra për konsolidimin e akteve bazë me aktet e tjera. Përgjegjësi i sektorit të arkivit elektronik konfirmon edhe aktet e përditësuara dhe vijon me publikimin në faqen *web* dhe ELI.

5. Arkivi Elektronik i Akteve duhet të ofrojë mundësinë e ndërveprimit me sisteme të tjera shtetërore.

6. Faqja *web* është e disponueshme 24 orë në ditë, si brenda e jashtë vendit, dhe aksesit që kanë përdoruesit e tij është, si më poshtë vijon:

a) subjektet fizike dhe juridike kanë akses të plotë në aktet juridike të publikuara;

b) institucionet shtetërore dërgojnë për botim aktet juridike të miratuara prej tyre dhe që janë të detyrueshme për t'u publikuar në Arkivin Elektronik të Akteve, sipas legjislacionit në fuqi.

7. Arkivi Elektronik i Akteve mundëson dy mënyra kërkimi:

a) Kërkimi në përmbajtje të tekstit përmes motorit të kërkimit në pamjen kryesore. Përdoruesit kërkojnë me fjalë kyçe e terma të caktuara dhe rezultatet e kërkimit paraqiten e listohen në rend kronologjik zbritës, duke nënvizuar e theksuar termat apo fjalët e kërkuara. Rezultatet e kërkimit përditësohen sipas kategorisë së përzgjedhur: Fletore Zyrtare/Akte/Buletini i Njoftimeve Zyrtare/Njoftime Zyrtare.

b) Kërkimi me filtra të avancuar i një akti të botuar bëhet mbi bazën e të dhënave që përmban faqja zyrtare elektronike e Qendrës së Botimeve Zyrtare, e cila konsiston në klikimin sipas llojit të aktit, vitit, numrit, titullit të aktit dhe institucioni përgjegjës.



8. Çdo akt që përmban Arkivi Elektronik i Akteve shkarkohet në formatin *word*, *PDF* dhe *RDF*.

VENDIM

Nr. 856, datë 24.12.2019

PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS, TË ELEMENTEVE PËRBËRËSE DHE TË AFATIT TË PËRDORIMIT TË CERTIFIKATËS ELEKTRONIKE TË GJENDJES GJYQËSORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9614, datë 21.6.2006, “Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore”, dhe të ligjit nr. 10273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e formës dhe të elementeve përbërëse të certifikatës së gjendjes gjyqësore, të ofruar përmes shërbimit publik elektronik, në përputhje me legjislacionin që rregullon nënshkrimin elektronik, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara, sipas variantit elektronik të shtojcave nr. 1 dhe nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij, përkatësisht:

a) shtojca nr. 1, për rezultatin “i dënuar”;

b) shtojca nr. 2, për rezultatin “i padënuar”.

2. Certifikata elektronike e gjendjes gjyqësore lëshohet me nënshkrimin dhe/ose vulën elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

3. Certifikata e gjendjes gjyqësore ofrohet përmes shërbimit publik elektronik për të gjithë shtetasit shqiptarë e të huaj, brenda dhe jashtë vendit, që janë të pajisur me kartë identiteti.

4. Certifikata elektronike e gjendjes gjyqësore, për përdorim brenda vendit, ka numër serial progresiv.

5. Dokumentet e përmendura në pikën 1, të këtij vendimi, lëshohen *online* nga nëpunësit e Zyrës së Gjendjes Gjyqësore nëpërmjet regjistrit elektronik të gjendjes gjyqësore.

6. Përmasat e fletëve të dokumenteve të përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, janë të formatit A-4.

7. Afati i përdorimit të certifikatës elektronike të gjendjes gjyqësore është 3 (tre) muaj nga data e lëshimit nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë.

8. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama



SHTOJCA NR. 1, “PËR REZULTATIN ‘I DËNUAR’”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Adresa: Rr. "Zef Serembe"

Tel/Fax: 00355 4 22 82 92

Nr. Prot _____

Tiranë më _____

VËRTETIM
I GJENDJES GJYQËSORE

Në zbatim të nenit 484 të Kodit të Procedurës Penale, të Republikës së Shqipërisë, nga verifikimet që iu bënë shënimeve në regjistrin gjyqësor pranë kësaj Ministrie, rezulton se shtetasi (emri, mbiemri) _____

i biri (e bija) i _____ dhe i _____

lindur më _____ në _____

me numër personal _____




Vuloa elektronike nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
Date: 2019/06/28 21:28:35 +0200
116212011

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vuloar me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve)



SHTOJCA NR. 2, “PËR REZULTATIN ‘I PADËNUAR’”


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Adresa: Rr. “Zef Serembe” Tel/Fax: 00355 4 22 82 92

Nr Prot Tiranë më

VËRTETIM
I GJENDJES GJYQËSORE

Në zbatim të nenit 484 të Kodit të Procedurës Penale, të Republikës së Shqipërisë, nga verifikimet që iu bënë shënimeve në regjistrin gjyqësor pranë kësaj Ministrie, rezulton se shtetasi (emri, mbiemri) i biri (e bija) i dhe i lindur më në me numër personal

ËSHTË I PADËNUAR

Spektori i Gjendjes Gjyqësore



Volosur elektronikisht nga Drejtoria e
Përgjithshme e Burgjeve
Data: 2019/06/25 21:25:35 +02:00
#18212011

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe volosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve)

**VENDIM****Nr. 857, datë 24.12.2019**

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
DHE TË KRITEREVE TË
KONKURRIMIT, FORMËN E
KOHËZGJATJEN E KONTRATËS DHE
METODOLOGJINË E ÇAKTIMIT TË
TARIFAVE PËR DHËNIEN NË
PËRDORIM TË PASURIVE
KULTURORE PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 178, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i procedurave dhe i kriterëve të konkurrimit, i formës e kohëzgjatjes së kontratës për dhënien në përdorim të pasurisë kulturore publike, si dhe i metodologjisë së çaktimit të tarifave.

2. Ky vendim nuk zbatohet në rastin e dhënies në përdorim të pasurive kulturore publike të administruara nga ana e fondacioneve, sipas parashikimeve të neneve 171 e 172, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

3. Ky vendim nuk zbatohet në rastin e veprimtarive kulturore dhe të veprimtarive tregtare të rregulluara përkatësisht nga nenet 100 e 102, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

II. KRITERET E KONKURRIMIT

1. Institucioni publik, për realizimin e politikave dhe të projekteve të tij për zhvillimin e qëndrueshëm të pasurisë kulturore, jep në përdorim pasurinë kulturore publike që ka në administrim.

2. Dhënia në përdorim e pasurisë kulturore publike nga institucioni publik që e ka në administrim bëhet në përputhje me destinacionin kulturor të pasurisë dhe miratohet me vendim të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurisë Kulturore (në vijim “KKMPK”). Dhënia në përdorim miratohet kur nuk cenohet ruajtja dhe mbrojtja e saj.

3. Vendimi i KKMPK-së përcakton pasuritë që jepen në përdorim sipas kreut III, të titullit V, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

4. Kriteret për dhënien në përdorim të pasurive kulturore publike janë si më poshtë vijnë:

a) Pasuria kulturore publike jepet në përdorim të drejtpërdrejtë, kur veprimtaria për të cilën jepet në përdorim:

i. është në përputhje me funksionin dhe vlerat kulturore të pasurisë së miratuar, sipas vendimit të KKMPK-së;

ii. promovon vlerat kulturore të pasurisë;

iii. garanton shfrytëzimin e pasurisë kulturore në kuptim të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, si dhe aksesin nga publiku;

iv. ofron shërbime cilësore për publikun.

b) Për dhënien në përdorim të pasurisë kulturore publike që jepet me qëllim rijetësimi, përveç kriterëve të përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 4, të këtij kreu, vlerësohet edhe:

i. plani i kryerjes së ndërhyrjeve ruajtëse dhe mbrojtëse, në varësi të objektit të veprimtarisë (plani i veprimtarisë);

ii. niveli i investimit në raport me ruajtjen e promovimin e pasurisë kulturore;

iii. cilësia e projektit të rijetësimit të propozuar, hartuar sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

5. Personi fizik ose juridik, që kërkon të marrë në përdorim një pasuri kulturore publike, përmbush kriteret si më poshtë vijnë:

a) personi fizik:

i. të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën e trashëgimisë kulturore;

ii. të jetë i regjistruar në regjistrat publikë;

iii. të mos jetë në procedura likuidimi dhe falimentimi;

iv. të ketë burimet e mjaftueshme financiare për marrjen në përdorim të pasurisë kulturore publike, duke vërtetuar disponimin e kapaciteteve financiare për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e projektit;

v. të disponojë kapacitetet teknike dhe ligjore për të marrë përsipër përdorimin e pasurisë kulturore;

vi. të disponojë personelin e specializuar ose të sigurojë bashkëpunimin me persona të specializuar;

b) personi juridik:



i. drejtuesi dhe/ose administratori të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën e trashëgimisë kulturore;

ii. të ketë fituar personalitet juridik nëpërmjet regjistrimit në regjistrat publikë;

iii. të mos jetë në procedura likuidimi dhe falimentimi;

iv. të ketë burimet e mjaftueshme financiare për marrjen në përdorim të pasurisë kulturore publike, duke vërtetuar disponimin e kapaciteteve financiare për mbulimin e shpenzimeve për realizimin e projektit;

v. të disponojë kapacitetet teknike dhe ligjore për të marrë përsipër përdorimin e pasurisë kulturore të paluajtshme, sipas formës së përdorimit të kërkuar;

vi. të disponojë personelin e specializuar ose të sigurojë bashkëpunimin me persona të specializuar.

6. Në rastin e procedurave për dhënie në përdorim me qëllim rijetësimi, subjektet e interesuara përmbushin edhe kriteret e parashikuara në pikën 5, të nenit 184, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

7. Në rastin kur subjekti i interesuar merr në përdorim pasurinë kulturore publike, e cila është pjesë e sistemit të zonave të mbrojtura mjedisore, bashkërendon punën me administratën rajonale të zonave të mbrojtura për ruajtjen dhe mirëmenaxhimin e pasurisë natyrore që administrohet nga kjo administratë.

III. PROCEDURA PUBLIKE PËR DHËNIEN NË PËRDORIM

A. Procedura publike për dhënien në përdorim me iniciativë të institucionit publik administruar të pasurisë kulturore

1. Procedura për dhënien në përdorim të pasurisë kulturore publike personave fizikë apo juridikë privatë fillon me iniciativë të institucionit publik administruar të pasurisë kulturore ose me kërkesë të subjektit të interesuar.

2. Në rastin kur procedura fillon me iniciativë të institucionit publik administruar të pasurisë kulturore publike, titullari i institucionit përkatës urdhëron hapjen e procedurës së konkurrimit për dhënien në përdorim të pasurisë kulturore publike, i cili përmban:

a) planvendosjen e pasurisë, hartuar nga një subjekt i licencuar ose hartën treguese të regjistrimit;

b) llojin e veprimtarisë që ushtrohet në pasurinë kulturore;

c) formën e dhënies në përdorim, si dhe mënyrën e destinacionin e përdorimit sipas vendimit të KKMPK-së;

ç) përbërjen e komisionit;

d) vlerën dysheme të kontratës për përdorimin e pasurisë;

dh) kriteret e konkurrimit dhe pikët vlerësuese;

e) kriteret e vlerësimit të konkurrimit (me pikë);

ë) afatin e lidhjes së kontratës;

f) datën, orën dhe vendin për paraqitjen e dokumenteve.

3. Për dhënien në përdorim të pasurisë kulturore publike me qëllim rijetësimi, hapja e procedurës së konkurrimit dhe përbërja e komisionit të dhënies në rijetësim kryhet në përputhje me nenin 184, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

4. Komisioni i dhënies në përdorim, me përjashtim të rastit të rijetësimit, sipas pikës 3 të këtij kreu, përbëhet nga kryetari dhe 4 (katër) anëtarë. Titullari i institucionit publik administruar të pasurisë kulturore cakton në komision nëpunës të institucionit që përmbushin këto kriteret:

a) zotërojnë diplomë universitare të ciklit të parë dhe të dytë në fushën juridike, ekonomike ose të shkencave sociale;

b) kanë përvojë pune profesionale me pasuritë kulturore, sipas tipologjisë dhe klasifikimit të pasurisë kulturore që jepet në përdorim.

5. Njoftimi për botim publikohet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe përmban elementet e parashikuara në pikën 2 të këtij kreu, me përjashtim të shkronjës “ç”.

6. Dokumentacioni i kërkuar paraqitet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e botimit të njoftimit.

7. Njoftimi për botim përmban dokumentacionin e kërkuar për plotësimin e kriterëve të përgjithshme. Për të provuar plotësimin e kriterëve të përgjithshme, subjektet e interesuara dorëzojnë dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) vetëdeklarim për gjendjen gjyqësore;

b) ekstrakt historik të regjistrimit të subjektit në regjistrat publikë;

c) dokumentacion financiar (vërtetim bankar i 3 (tre) muajve të fundit);

ç) dokumentacion tatimor, sipas përcaktimeve të komisionit në varësi të projektit;



d) dokumentacion teknik, sipas përcaktimeve të komisionit në varësi të projektit;

dh) vërtetim nga tatimet për numrin e punonjësve.

8. Dosja e dorëzuar, përveç dokumentacionit të përcaktuar në pikën 7 të këtij kreu, përmban dhe dokumentet specifike në varësi të formës së dhënies në përdorim, si më poshtë vijon:

a) për dhënien në përdorim të drejtpërdrejtë:

i. propozimin për marrjen në përdorim të pasurisë kulturore publike;

ii. projektin për veprimtarinë;

iii. planin e menaxhimit të pasurisë kulturore publike që kërkohet të merret në përdorim;

iv. tipologjinë e shërbimeve që mendohet të ofrohen;

v. garancinë për miradministrimin e pronës, në formën e një vërtetimi bankar, të 3 (tre) muajve të fundit nga data e dorëzimit të dokumentacionit, në vlerën jo më pak se 10 (dhjetë) % të projektit të propozuar;

vi. vërtetim për xhiron mesatare vjetore të 3 (tri) viteve të fundit, në vlerën prej minimalisht 50 (pesëdhjetë) % të vlerës së investimit të parashikuar në projektin e propozuar;

b) për dhënien në përdorim me qëllim rijetësimi:

i. propozimin për marrjen në përdorim të pasurisë kulturore;

ii. projektin e rijetësimi, sipas nenit 185, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;

iii. analizën e detajuar të projektit;

iv. planin e zhvillimit të territorit;

v. dokumentacionin për pjesëmarrje në projekte të mëparshme;

vi. garancinë për miradministrimin e pronës, në formën e një vërtetimi bankar, të 3 (tre) muajve të fundit nga data e dorëzimit të dokumentacionit, në vlerën jo më pak se 10 (dhjetë) % të projektit të propozuar;

vii. vërtetim për xhiron mesatare vjetore të 3 (tri) viteve të fundit, në vlerën prej minimalisht 50 (pesëdhjetë) % të vlerës së investimit të parashikuar në projektin e propozuar.

9. Dokumentacioni i mësipërm paraqitet në gjuhën shqipe, origjinal ose i njëjësuar me origjinalin. Dokumentet nga shtetet e huaja paraqiten të legalizuara, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara sipas legjislacionit në fuqi.

10. Subjektet e interesuara për të marrë pjesë në konkurrimin publik dorëzojnë dokumentacionin e mësipërm pranë protokollit të institucionit publik që zhvillon procedurën ose me postë fizike, ose elektronike, në adresën, datën dhe orën e përcaktuar në njoftimin për botim.

11. Komisioni shqyrton e vlerëson dokumentacionin e paraqitur brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga përfundimi i afatit të dorëzimit.

12. Mungesa e dokumenteve që vërtetojnë plotësimin e ndonjërit prej kriterëve të përcaktuara në kreun II të këtij vendimi, sjell skualifikimin e subjektit të interesuar. Ky fakt konstatohet në relacionin përfundimtar të komisionit.

13. Procesi i vlerësimit vazhdon edhe kur është paraqitur së paku një propozim i vlefshëm. Propozim i vlefshëm konsiderohet propozimi që nuk mund të skualifikohet sipas parashikimeve të këtij vendimi.

14. Komisioni bën vlerësimin e projektit dhe të elementeve të tjera të konkurrimit, sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim.

15. Në përfundim të procesit, brenda afatit të përcaktuar në pikën 11 të këtij kreu, komisioni, pasi shqyrton ofertat dhe dokumentacionin e paraqitur, harton relacionin përfundimtar për vlerësimin e subjekteve të interesuara.

16. Komisioni bën renditjen e subjekteve të interesuara të kualifikuara sipas pikëve të përfituara, si dhe përcakton listën e subjekteve të skualifikuara, për shkak të mungesës së dokumentacionit, në relacionin përfundimtar.

17. Relacioni përfundimtar i komisionit i përcillet për miratim titullarit të institucionit publik, i cili, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nxjerr vendimin përkatës.

18. Vendimi i titullarit u njoftohet subjekteve të interesuara brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga marrja e tij.

19. Subjektet e interesuara, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga njoftimi i vendimit, kanë të drejtën e ankimit te titullari i institucionit, i cili, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike, i kthen përgjigje me shkrim ankuesit.

20. Subjektet e interesuara mund të ankimojnë vendimin përfundimtar të titullarit të institucionit në gjykatën kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.



21. Pas përfundimit të procedurave të lartpërmendura fillojnë procedurat për hartimin dhe lidhjen e kontratës.

22. Fituesi, përpara lidhjes së kontratës, paraqet garancinë e kontratës në masën 5 (pesë) % të investimit, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit të vendimit të titullarit të institucionit publik.

23. Garancia lëshohet nga një institucion financiar bankar ose jobankar që ushtron aktivitet brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

24. Në rast se subjekti fitues tërhiqet përpara afatit të përcaktuar në pikën 22 të këtij kreu, fitues shpallet subjekti pasardhës, i cili njoftohet zyrtarisht.

25. Institucioni publik njofton fituesin për lidhjen e kontratës për dhënien në përdorim të pasurisë kulturore publike, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e njoftimit.

26. Subjekti që merr në përdorim pasurinë kulturore publike ndërmerr të gjitha masat ruajtëse e mbrojtëse, si dhe masat e menjëhershme, në rast rreziku të kësaj pasurie, në përputhje me kontratën e lidhur dhe legjislacionin në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe muzetë.

B. Procedura publike për dhënien në përdorim me kërkesë të subjektit të interesuar

1. Procedura për dhënien në përdorim të pasurisë kulturore publike personave fizikë apo juridikë privatë fillon edhe me kërkesë të subjektit të interesuar.

2. Subjekti i interesuar paraqet, pranë institucionit që administron pasurinë kulturore publike, kërkesën për shprehjen e interesit të shoqëruar nga dokumentacioni, si më poshtë vijon:

a) kërkesë për shprehje interesi, në të cilën identifikohet pasuria kulturore publike, e cila kërkohet të merret në përdorim;

b) projekt për veprimtarinë që do të zhvillohet, ku, ndër të tjera, duhet të përfshihet lloji i veprimtarisë, koha kur do të zhvillohet, argumentet për përputhshmërinë e projektit të veprimtarisë me destinacionin kulturor të pasurisë dhe masat e planifikuara për sigurimin e aksesit të publikut në pasurinë kulturore në varësi të projektit të propozuar.

3. Në rastin e kërkesës për marrjen në përdorim me qëllim rijetësimi, dokumentacioni i parashikuar në pikën 6, të nenit 184, të ligjit 27/2018, “Për

trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, shoqërohet edhe nga dokumentacioni, si më poshtë vijon:

a) plani i biznesit përkatës i detajuar për vënien në funksionim të pasurisë kulturore, ku të përshkruhet qartë plani i punësimit, i investimit dhe treguesit e tjerë që do të realizohen;

b) një deklaratë në të cilën pranohet plani i menaxhimit për këtë pasuri ose, në rastin kur ky plan nuk ekziston, deklaratë për bashkëpunimin me autoritetet kompetente për hartimin e planit të menaxhimit para marrjes në përdorim të pasurisë kulturore përkatëse;

c) dokument që vërteton zotërimin e mjeteve financiare për të zhvilluar projektin e marrjes në administrim të pasurisë kulturore të paluajtshme.

4. Institucioni publik që administron pasurinë kulturore publike shqyrton kërkesën brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të dokumentacionit në protokoll. Në rastin kur shprehja e interesit miratohet nga institucioni publik, ky i fundit procedon me hapjen e konkurrimit publik, sipas këtij kreu. Në rastin kur kërkesa nuk miratohet, institucioni publik i kthen subjektit letërën për shprehje interesi së bashku me dokumentacionin shoqëruar si më sipër.

IV. FORMA DHE KOHËZGJATJA E KONTRATËS PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË PASURISË KULTURORE PUBLIKE

Kontrata për dhënien në përdorim të pasurisë kulturore publike lidhet me shkrim, në formën e qirasë ose të enfiteozës, sipas parashikimeve të Kodit Civil. Kontrata përmban të paktën elementet e mëposhtme:

a) gjenealogjetet e palëve;

b) formën e dhënies në përdorim (të drejtpërdrejtë ose me qëllim rijetësimi);

c) objektin e dhënies në përdorim të pasurisë;

ç) destinacionin e dhënies në përdorim;

d) shërbimet që do të garantohen për të siguruar shfrytëzimin publik të pasurisë, në varësi të projektit;

dh) nivelet cilësore të aktiviteteve dhe të shërbimeve që do të ofrohen;

e) kohëzgjatjen e kontratës. Kohëzgjatja e dhënies në përdorim përcaktohet në përputhje me kohëzgjatjen e projektit dhe përmbushjen e qëllimit për të cilin është dhënë në përdorim;

ë) të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve;

f) format e shpërblimit të dëmit dhe penalitetet;



g) çmimin/tarifat dhe mënyrën e pagesës së tyre;

gj) procedurat për zgjidhjen e kontratës;

h) procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

V. METODOLOGJIA E CAKTIMIT TË TARIFAVE TË DHËNIES NË PËRDORIM TË PASURISË KULTURORE PUBLIKE

1. Parimet e përgjithshme të metodologjisë janë:

a) parimi i eficiencës në menaxhimin e pasurive kulturore;

b) parimi i transparencës në përcaktimin e tarifave të dhënies në përdorim.

2. Llojet e tarifave për dhënien në përdorim të pasurive kulturore:

a) tarifat për përdorim të drejtpërdrejtë;

b) tarifat për përdorim me qëllim rijetësimi.

3. Caktimi i tarifave për dhënien në përdorim të pasurive kulturore publike bazohet në këto tipologji të pasurive kulturore:

a) pasuritë e luajtshme;

b) pasuritë e paluajtshme.

4. Caktimi i tarifave për pasuritë kulturore materiale bazohet në klasifikimin e pasurive kulturore në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, në nënkategoritë e tyre, sipas neneve 53 e 54, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, dhe ndërveprimit me secilin prej elementeve të mëposhtme:

a) për pasuritë kulturore të paluajtshme tarifa përcaktohet duke marrë në konsideratë:

i. formën e dhënies në përdorim (të drejtpërdrejtë ose me qëllim rijetësimi). Rëndësia e këtij kriteri duket, veçanërisht, në rastin e dhënies në përdorim të drejtpërdrejtë dhe të dhënies me qëllim rijetësimi. Dhënia në përdorim me qëllim rijetësimi përfshin kryerjen nga ana e përdoruesit të një sërë përmirësimesh dhe kohëzgjatjeje të kontratës deri në 20 (njëzet) vjet me të drejtë rinovimi. Të dyja këto elemente (kryerja e përmirësimeve e kohëzgjatja) ndikojnë thellësisht në elementet e tjera të sipërpërmendura. Konkretisht, lloji i veprimtarisë që do të zhvillohet, kohëzgjatja e kontratës, llojet e përmirësimit dhe projekti që do të kryhet ndikojnë në nivelin e vizitueshmërisë së pasurisë;

ii. sipërfaqen e pasurisë: ky kriter është i lidhur edhe me vlerën e pasurisë kulturore;

iii. klasifikimin e pasurisë kulturore;

iv. vlerën e pasurisë kulturore të përcaktuar nga një ekspert vlerësues i pasurisë së paluajtshme nga lista e publikuar nga IKRTK-ja/IKTK-ja. Ky kriter mund të ndikojë në caktimin e tarifës së përdorimit, duke i llogaritur amortizimin;

v. kapacitetin e pasurisë: ky element ndikon drejtpërdrejt në sasinë e biletave që do të porositen nga organizatori dhe në bazë të së cilës do bëhet planifikimi i të ardhurave nga veprimtaria që do organizohet;

vi. nivelin e vizitueshmërisë së pasurisë: nëse pasuria e paluajtshme ka një nivel të lartë vizitueshmërie, ky kriter ndikon në pritshmëritë e përdoruesit në vizitueshmërinë e aktivitetit dhe, në rast se pjesëmarrja në aktivitet është me pagesë, ky fakt pasqyrohet në sasinë e biletave që shet përdoruesi;

vii. vlerësimin e lehtësirave që kanë ose jo pasuritë kulturore publike: nëse në hapësirën që do të jepet në përdorim nuk ka tualete funksionale ose lehtësira të tjera që janë të nevojshme për zhvillimin e aktivitetit, do të merret në konsideratë për përjashtimin nga tarifa e dhënies në përdorim të shpenzimeve që përdoruesi do të bëjë për sigurimin e këtyre lehtësirave;

viii. qarkun ku ndodhet pasuria kulturore, me qëllim edhe shqyrtimin e nivelit të zhvillimit ekonomik të qarkut përkatës;

b) për pasuritë kulturore të luajtshme tarifa përcaktohet duke marrë në konsideratë:

i. formën e dhënies në përdorim;

ii. vlerën e pasurisë kulturore, përcaktuar nga një ekspert vlerësues i pasurisë së luajtshme kulturore nga lista e publikuar nga IKRTK-ja/IKTK-ja;

iii. klasifikimin e pasurisë;

iv. llojin e veprimtarisë që do të zhvillohet;

v. përmasat dhe peshën;

vi. shpenzimet për lëvizjen e pasurisë;

vii. shpenzimet për kushtet atmosferike ku ruhet;

viii. numrin e punonjësve në dispozicion të aktivitetit, duke përfshirë këtu edhe punonjësit e sigurisë;

c) në rastin e pasurive të paluajtshme, vlerësimi për secilin prej kriterëve të sipërpërmendura ndryshon në varësi të formës së dhënies në përdorim dhe të kategorisë së pasurisë së paluajtshme që merret në përdorim.



5. Në rastin e dhënies në përdorim me qëllim rritjesimi të një pasurie kulturore publike të paluajtshme merret në konsideratë:

- a) sipërfaqja e pasurisë;
- b) kapaciteti;
- c) vlera e pasurisë kulturore;
- ç) lloji i veprimtarisë që do të zhvillohet;

d) projekti i rritjesimit, veçanërisht, për sa u përket përmirësimeve dhe kohëzgjatjes së kontratës, pasi këta dy faktorë ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në elementet e tjera, si: në nivelin e vizitueshmërisë së pasurisë, në vlerësimin e lehtësirave që kanë ose jo pasuritë, numri i punonjësve të administratorit ose të pronarit që do të vihen në dispozicion të veprimtarisë, duke përfshirë këtu edhe punonjësit e sigurisë.

6. Në rastin e dhënies në përdorim të drejtpërdrejtë, bëhet një vlerësim individual i secilit prej kriterëve të mëposhtme:

a) klasifikimi i pasurisë kulturore, sipas nenit 53, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”;

b) vlera e pasurisë kulturore, sipas vlerësimit të bërë nga një ekspert vlerësues i pasurisë kulturore;

c) kapaciteti: për sa i përket kapacitetit, merret në konsideratë edhe lloji i aktivitetit, i cili mund të jetë i tillë që mund të mos plotësojë të gjithë kapacitetin maksimal të pasurisë ose, për arsye të ruajtjes e të mbrojtjes, nuk mund të shfrytëzohet i gjithë kapaciteti maksimal. Në këtë rast merret në konsideratë niveli i vizitueshmërisë së vetë pasurisë;

ç) numri i punonjësve që do të vihet në dispozicion të përdorimit dhe lloji i veprimtarisë që do të zhvillohet, nëse është fitimprurës ose jo.

7. Rëndësia apo vlerësimi i secilit prej kriterëve të lartpërmendura ndryshon rast pas rasti në varësi të llojit të pasurisë që është objekt dhënieje në përdorim.

8. Në rastin e dhënies në përdorim të pasurive të luajtshme, elementet që ndikojnë në caktimin e tarifës janë:

- a) vlera e pasurisë kulturore;
- b) klasifikimi i pasurisë kulturore;
- c) shpenzimet për lëvizjen e pasurisë dhe për kushtet atmosferike të transportit dhe të vendit ku do të zhvendoset e do të qëndrojë;

ç) numri i punonjësve që do të angazhohen në lëvizjen ose çdo lloj shërbimi tjetër që nuk mund të kryhet nga punonjësit të marrësit në përdorim;

d) lloji i aktivitetit për të cilin do të përdoret, që ndikon indirekt në përcaktimin e shpenzimeve për kushte atmosferike, në të cilat do të qëndrojë pasuria kulturore, si dhe fakti nëse është fitimprurës ose jo.

VI. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Ngarkohen Ministria e Kulturës dhe të gjitha institucionet që kanë në administrim pasuri kulturore publike për zbatimin e këtij vendimi.

2. Çdo akt nënligjor që bie në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 858, datë 24.12.2019

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË CIRKUT KOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3, të nenit 9, të ligjit nr. 10352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Ilirjan Gjini emërohet drejtor i Circuit Kombëtar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM
Nr. 859, datë 24.12.2019

PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN,
ORGANIZIMIN DHE DETYRAT E
KOMISIONIT PËR PRODHIMIN
BIOLOGJIK¹

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 32, të ligjit nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Përbërja e Komisionit për Prodhimin Biologjik

1. Komisioni për Prodhimin Biologjik (në vijim “KPB”) përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë, kryesohet nga zëvendësministri i ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe ka këtë përbërje:

a) drejtori i drejtorisë së përgjithshme, përgjegjëse për prodhimin biologjik, në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë;

b) drejtori i drejtorisë, përgjegjëse për prodhimin biologjik, në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë;

c) përgjegjësi i sektorit, përgjegjës për prodhimin biologjik, në ministrinë përgjegjëse për bujqësinë;

ç) një përfaqësues nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;

d) një përfaqësues nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit;

dh) një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit;

e) një përfaqësues nga institucionet jopublike në fushën e bujqësisë biologjike;

ë) një përfaqësues nga Universiteti Bujqësor i Tiranës.

2. Anëtarët e Komisionit propozohen nga institucionet përkatëse dhe emërohen me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (në vijim “ministri”).

II. Organizimi dhe funksionimi i Komisionit për Prodhimin Biologjik

1. Komisioni për Prodhimin Biologjik (KPB) në mbledhjen e parë zgjedh sekretarin.

2. Mbledhjet e KPB-së thirren nga kryetari, minimalisht 4 (katër) herë në vit, bazuar në kërkesat e paraqitura për miratim dhe sipas informacionit të marrë nga njësia për prodhimin biologjik për shqyrtimin e raporteve të mbikëqyrjes së trupave të kontrollit të miratuara.

3. Mbledhjet e jashtëzakonshme thirren nga kryetari.

4. Çdo anëtar i KPB-së duhet të deklarojë që nuk ka konflikt interesi, sipas legjislacionit në fuqi për konfliktin e interesit, dhe deklaratën ia paraqet kryetarit të KPB-së.

5. Anëtarët e KPB-së janë të detyruar të ruajnë sekretin profesional dhe konfidencialitetin e diskutimeve, të dokumenteve dhe të çdo informacioni që u vihet në dispozicion, gjatë zbatimit të procedurave të miratimit dhe të mbikëqyrjes së trupave të kontrollit, sipas legjislacionit në fuqi për ruajtjen e të dhënave personale dhe për të drejtën e informimit.

6. Anëtarët e KPB-së njoftohen nga sekretari nëpërmjet postës elektronike për datën dhe rendin e ditës të mbledhjes, të paktën 5 (pesë) ditë pune, para ditës së mbledhjes.

7. Kryetari mund të paraqesë çështje të tjera që nuk janë të përfshira në rendin e ditës të paraqitur paraprakisht, nëse 2/3 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për këto çështje.

8. Kuorumi i nevojshëm për realizimin e mbledhjes së KPB-së realizohet kur në të marrin pjesë të paktën 5 (pesë) prej anëtarëve, përfshirë dhe kryetarin.

9. Në rast mungese, kryetari dhe sekretari zëvendësohen përkohësisht, përkatësisht nga

¹ Ky vendim është përafuar pjesërisht me rregulloren e Komisionit (KE) nr. 1235/2008, datë 8 dhjetor 2008, që përcakton rregulla të hollësishme për zbatimin e rregullores së Këshillit (KE) nr. 834/2007, në lidhje me marrëveshjet për importet e produkteve organike nga vendet e treta, numri CELEX: 32008R1235, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L nr. 334, 12.12.2008, faqe 25–52 dhe rregulloren e Këshillit (KE) nr. 889/2008, datë 5 shtator 2008, që përcakton rregullat e hollësishme për zbatimin e rregullores së Këshillit 834/2007, “Për prodhimin biologjik dhe etiketimin e produkteve biologjike, në lidhje me prodhimin biologjik, etiketimin dhe kontrollin”, të ndryshuar. Numri CELEX: 02008R0889-20160507, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 250, datë 18.9.2008, faqe 1–17.



anëtari më i vjetër dhe nga anëtari më i ri në detyrë, që të dy me të drejtë vote.

10. Largimi i anëtarit të KPB-së bëhet me urdhër të ministrit për njërën nga arsyet e mëposhtme:

a) nëse nuk paraqitet në tri mbledhje të njëpasnjëshme të KPB-së dhe nuk paraqet justifikime të provuara për këto mungesa;

b) kur i është ndaluar ushtrimi i profesionit me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) kur nuk gëzon funksionin për të cilin është emëruar.

11. Anëtari i KPB-së që jep dorëheqjen është i detyruar të paraqesë kërkesën me shkrim për dorëheqje dhe arsyet e dorëheqjes, të paktën 1 (një) muaj përpara datës së largimit nga detyra, përveç rastit kur provon ose vërtetohet se kjo nuk ka qenë e mundur.

12. KPB-ja merr masa për zëvendësimin sa më shpejt të anëtarit të larguar nga detyra ose të dorëhequr, duke u dërguar institucioneve përkatëse kërkesën për caktim të përfaqësuesit.

13. Procedura për zhvillimin e mbledhjes së KPB-së është, si më poshtë vijon:

a) çelet nga kryetari, i cili kërkon aprovimin paraprak të rendit të ditës me ndryshimet (nëse ka);

b) sekretari paraqet verbalisht përpara KPB-së një pasqyrë të përmbledhur të çështjeve për diskutim;

c) KPB-ja, nën drejtimin e kryetarit, shtron për diskutim me radhë të gjitha çështjet që janë vendosur në rendin e ditës;

ç) kryetari i fton anëtarët të votojnë në përfundim të të gjithë procedurës së shqyrtimit të kërkesës e dokumentacionit për miratim ose të raportit të mbikëqyrjes të paraqitur nga Njësia për Prodhimin Biologjik. Asnjë nga anëtarët nuk mund të abstenojë nga vendimmarrja. Votimi është i hapur në të gjitha rastet. Mendimi i anëtarit të mbetur në pakicë, i parashtruar me shkrim, bashkohet me vendimin dhe nënshkruhet me fjalën “kundër”;

d) vendimet e KPB-së miratohen me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm;

dh) në rast se votimi është i barabartë, vota e kryetarit është vendimtare;

e) procesverbali mbahet nga sekretari dhe u paraqitet për miratim të gjithë anëtarëve në fillim të mbledhjes pasuese dhe, pas miratimit, firmoset nga kryetari e sekretari;

ë) dokumentacioni i prodhuar gjatë gjithë procedurës u nënshtrohet rregullave në fuqi për arkivin.

14. Vendimet e KPB-së për miratimin, refuzimin apo shfuqizimin e vendimit për miratimin e trupave të kontrollit i dërgohen ministrit për miratim.

15. KPB-ja njofton me shkrim trupat e kontrollit për miratimin, refuzimin apo shfuqizimin e vendimit të miratimit, duke argumentuar arsyet e refuzimit të kërkesës për miratim ose të shfuqizimit të vendimit të miratimit.

III. Detyrat e Komisionit për Prodhimin Biologjik dhe të Njesisë për Prodhimin Biologjik

A. Detyrat e KPB-së janë:

1. Shqyrton kërkesën për miratim së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga trupa e kontrollit. Nëse, pas verifikimit të këtij dokumentacioni, rezulton se ka mangësi, Komisioni i kërkon trupës së kontrollit që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh pune, të plotësojë mangësitë. Në rastin e mosplotësimit në afat të mangësive, Komisioni njofton trupën e kontrollit që kërkesa nuk do të shqyrtohet.

2. Miraton ose refuzon kërkesat e trupave të kontrollit, vendëse apo të huaja, për të ushtruar aktivitetin e inspektimit dhe të certifikimit të operatorëve biologjikë në territorin e Shqipërisë.

3. Shfuqizon vendimin e miratimit të trupave të kontrollit, që ushtrojnë aktivitetin e inspektimit dhe të certifikimit të operatorëve biologjikë në territorin e Shqipërisë, të cilat nuk vazhdojnë të përmbushin kërkesat e ligjit nr. 106/2016, “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre” (në vijim “ligji”).

4. Vlerëson raportin e paraqitur nga njësia për prodhimin biologjik, pas kryerjes së mbikëqyrjes së aktivitetit të trupave të kontrollit, të miratuara sipas përcaktimit të nenit 32/2, të ligjit, dhe merr vendim lidhur me vlerësimin e aktivitetit të trupës së kontrollit.

B. Detyrat e Njesisë për Prodhimin Biologjik janë:

Harton e mirëmban regjistrin e trupave të kontrollit, të miratuara nga KPB-ja dhe e publikon në faqen zyrtare të internetit të ministrisë. Regjistri përmban:



a) emrin, adresën, numrin kodues të trupës së kontrollit, adresën e *email*-it dhe faqen zyrtare të internetit;

b) fushën dhe kategoritë e produkteve të certifikuara;

c) faqen zyrtare të internetit, ku gjendet lista e përditësuar e operatorëve në sistem certifikimi, e cila përmban statusin e certifikimit, kategoritë e produkteve dhe pikën e kontaktit për të marrë informacionin, në rast pezullimi apo heqjeje certifikimi të operatorit apo të produktit;

ç) faqen zyrtare të internetit ku gjendet informacioni për standardin dhe masat e kontrollit të zbatuara nga trupa e kontrollit.

2. Publikon në faqen zyrtare të internetit të ministrisë listën e përditësuar të të gjithë operatorëve të prodhimit, përpunimit e tregtimit të produkteve biologjike.

3. Kryen mbikëqyrjen e trupave të kontrollit për llogari të KPB-së, që konsiston në vlerësimin e aktivitetit të trupave të kontrollit të miratuara, duke marrë në konsideratë edhe raportin e rezultatet e auditimit nga organi akreditues. Gjatë mbikëqyrjes, kryen kontrollin e dokumentacionit dhe inspektimin vjetor, nëse zbatohen procedurat e dokumentuara dhe, në veçanti, verifikon:

a) përpunshmërinë e procedurave standarde të kontrollit të zbatuara me ato të paraqitura nga trupa e kontrollit të KPB-ja në momentin e miratimit;

b) menaxhimin dhe ekzaminimin e dosjeve të kontrollit të operatorëve biologjikë, në përputhje me kërkesat e ligjit;

c) nëse trupa e kontrollit ka numër të mjaftueshëm stafi të kualifikuar dhe me përvojë të përshtatshme, në përputhje me nenin 31, të ligjit, dhe nëse janë zbatuar trajnime lidhur me rreziqet që ndikojnë në statusin organik të produkteve;

ç) trajtimin e jokonformiteteve të konstatuara gjatë inspektimit dhe kontrollit;

d) trajtimin e ankesave dhe të apeliemeve të operatorëve biologjikë;

dh) nëse trupa e kontrollit ka dhe ndjek procedura e modele formulari të dokumentuara, për:

i. analizën vjetore të rrezikut, në përputhje me pikën 3, të nenit 30, të ligjit;

ii. përgatitjen e një plani menaxhimi me bazë risku për marrjen e mostrave dhe analizat laboratorike;

iii. shkëmbimin e informacionit me trupat e tjera të kontrollit dhe autoritetin kompetent;

iv. kontrollet fillestare dhe në vijim të operatorëve nën sistemin e saj të kontrollit;

v. zbatimin dhe vijueshmërinë e masave që duhen marrë në rast shkeljeje apo parregullsie;

vi. zbatimin e kriterëve për mbrojtjen e të dhënave personale të operatorëve nën kontrollin e saj në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

e) nëse zbaton rregullat për rotacionin e inspektorëve;

ë) nëse zbaton sistemin e gjurmueshmërinë për çdo produkt në të gjitha statet e prodhimit, të përgatitjes dhe të shpërndarjes.

Për të kryer mbikëqyrjen e trupave të kontrollit, Njësia e Prodhimit Biologjik mund të bashkëpunojë me specialistë të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, që caktohen me urdhër ministri.

4. Mban raportin pas çdo kontrolli dhe inspektimi të kryer, i cili firmoset nga përfaqësuesi i trupës së kontrollit dhe grupi i kontrollit e ia paraqitet KPB-së për vlerësim.

IV. Dispozita të fundit

1. Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për anëtarët e KPB-së, bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 861, datë 24.12.2019

PËR MËNYRËN E NJOHJES SË AUDITUESVE KLINIKË, KRYERJEN E PROCESIT TË AUDITIMIT DHE PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË PAGESËS SË AUDITUESVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4, të nenit 25, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

I. Dispozita të përgjithshme

1. Projektvendimi ka për qëllim përcaktimin e:

a) rregullave për mënyrën e kryerjes së procesit të auditimit klinik;

b) rregullave për mënyrën e njohjes së audituesve klinikë, vendas ose të huaj, që do të kontrollojnë e do të vlerësojnë procedurat e praktikave mjekësore të ndjekura prej institucioneve të kujdesit shëndetësor, publik dhe privat;

c) tarifës së pagesës së audituesve klinikë.

2. Auditimi klinik është auditim i praktikës mjekësore, sipas protokolleve klinike dhe udhërrëfyesve të kujdesit shëndetësor, bazuar në fakte, si dhe analiza sistematike, përdorur nga profesionistët e shëndetit për të vlerësuar e përmirësuar kujdesin ndaj pacientëve, duke përfshirë procedurat e përdorura për diagnostikim e trajtim, me qëllim përmirësimin e kujdesit ndaj qytetarëve dhe të cilësisë së shërbimit të ofruar.

3. Misioni i auditimit klinik është të kontrollojë e të vlerësojë nëse procedurat mjekësore të ndjekura nga institucionet e kujdesit shëndetësor, publik dhe privat, janë në përputhje me protokollet, udhërrëfyesit, rregullat e miratuara për trajtimin e pacientëve dhe marrjen e vendimeve të sakta për shëndetin, duke krahasuar praktikën aktuale klinike të ndjekur me standardet, protokollet dhe udhëzimet ekzistuese.

4. Auditimi klinik në institucionet e kujdesit shëndetësor duhet të kryhet, si rregull, çdo dy vjet. Përjashtim nga ky rregull bëjnë institucionet e kujdesit shëndetësor që kanë kontratë me FSDKSH-në për financimin e paketave të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, te të cilat duhet të kryhet çdo vit.

5. Audituesit klinikë mund të jenë vendas ose të huaj, që njihen nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim.

6. Shpenzimet e auditimit mbulohen nga institucioni që auditohet.

II. Mënyra e njohjes së audituesve klinikë

1. Auditues klinik është çdo person fizik vendas që plotëson këto kritere:

a) ka profesionin mjek/farmacist/stomatolog;

b) ka minimumi 15 vjet eksperiencë profesionale në sistemin shëndetësor, të vërtetuar

nga institucionet publike dhe jopublike të certifikuara dhe të akredituara sipas legjislacionit në fuqi;

c) ka titullin profesor, profesor i asociuar;

ç) vetëdeklaroi se ka njohuri për përdorimin e kodifikimit mjekësor (ICD);

d) vetëdeklaroi se ka njohuri për auditin klinik dhe manualin e procedurave të auditit klinik;

dh) vetëdeklaroi se ka njohuri mbi protokollet dhe udhërrëfyesit e praktikës mjekësore dhe standardet e akreditimit për fushën përkatëse.

2. Audituesit e huaj klinikë duhet të jenë të njohur si të tillë në vendin e tyre dhe të kenë eksperiencë si auditues klinikë të certifikuar.

3. Ministri përgjegjës për shëndetësinë ngre, me urdhër, komisionin e vlerësimit të audituesve klinikë me përfaqësues nga administrata e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

4. Personat e interesuar për t'u përzgjedhur si auditues klinikë kombëtarë aplikojnë pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, duke paraqitur një kërkesë për shprehje interesi për t'u njohur si auditues klinikë dhe të vërtetojnë, me dokumentacionin shoqërues, që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 1, të kreut II.

5. Komisioni i vlerësimit shqyrton dokumentacionin e paraqitur dhe shpall në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë listën e personave të kualifikuar.

6. Personat e përzgjedhur si auditues klinikë do të shpallen si audituesit kombëtarë klinikë në Regjistrin Kombëtar të Audituesve Klinikë, i cili publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë. Personat që nuk janë përzgjedhur do të njoftohen nga komisioni i vlerësimit, i cili do të japë dhe arsyet e mospërzgjedhjes.

7. Të gjithë personat që nuk janë përzgjedhur për auditues klinikë kanë të drejtë të ankohen pranë ministrit përgjegjës për shëndetësinë brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit. Vendimi i ministrit përgjegjës për shëndetësinë është përfundimtar.

III. Mënyra e kryerjes së procesit të auditimit klinik

1. Auditimi klinik kryhet me kërkesë të ministrit përgjegjës për shëndetësinë ose vetë institucionit të kujdesit shëndetësor. Secili nga institucionet që kërkon auditimin, përzgjedh audituesin nga Regjistri Kombëtar i Audituesve Klinikë.



2. Auditimi klinik do të kryhet sipas fazave dhe rregullave të parashikuara, si më poshtë vijon:

A. Përgatitja dhe planifikimi

1. Identifikimi i subjektit të auditimit:

a) subjekt i auditimit është institucioni i kujdesit shëndetësor publik dhe privat;

b) auditimi përgatitet sipas një plani auditimi, me burime financiare, teknike dhe personel, ku përcaktimi i përparësive të auditimit bëhet prej ekipit të menaxhimit të institucionit të kujdesit shëndetësor, në bashkëpunim me ekipin e auditimit/audituesin;

c) plani i auditimit përcaktohet në manualin e procedurave standarde operacionale të auditit klinik, të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

2. Planifikimi

Auditimi klinik zhvillohet sipas një plani auditimi, që përfshin:

a) identifikimin e protokollit/udhëzuesit klinikë, objekt auditimi;

b) vënien në dispozicion nga institucioni i kujdesit shëndetësor të praktikës mjekësore, objekt auditimi;

c) planifikimin e burimeve financiare, njerëzore, stafit klinik, për teknikat e kontrollit teknik, mbledhjen dhe menaxhimin e të dhënave, infrastrukturën logjistike (kompjuter, *hardware*, *software*).

B. Mbledhja dhe analiza e të dhënave

1. Mbledhja e të dhënave të nevojshme për auditim përfshin:

a) të dhëna në retrospektivë, që bazohen në dokumentacionin e kaluar;

b) të dhëna në perspektivë;

c) të dhëna sasiore ose cilësore, siç janë intervistat, pyetësorët ose komentet;

ç) të dhënat mjekësore, rezultatet e vlerësimeve biokimike dhe instrumentale;

d) në rastin e mbledhjes së të dhënave drejtpërdrejtë nga pacientët, gjatë auditimit, shpjegimin e procesit të mbledhjes së të dhënave dhe marrjen e pëlqimit të tyre.

2. Të dhënat e mbledhura analizohen:

a) duke përfshirë përdorimin e regjistrave mjekësorë;

b) duke respektuar dhe siguruar privatësinë e pacientit me skedarë anonimë.

3. Vlerësimi i auditimit bëhet duke u bazuar në të dhëna/statistika të mbledhura të besueshme,

duke i krahasuar me parametrat e vendosur dhe të përcaktuar.

4. Audituesi klinik duhet të krahasojë standardet e paracaktuara me të dhënat aktuale të mbledhura dhe të bëjë lidhjen ndërmjet praktikës e standardeve teorike, për të treguar nëse standardi mund të arrihet ose jo. Nëse standardi nuk është përmbushur, audituesi duhet të shënojë shkaqet, nëse ato dihen.

5. Audituesi, në përfundim të procesit të auditimit klinik, duhet t'i dorëzojë, brenda 30 ditëve, raportin e auditit klinik, bashkë me rekomandimet për institucionin e kujdesit shëndetësor, ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe institucionit të kujdesit shëndetësor.

C. Veprimet korrigjuese dhe udhëzuesit

1. Audituesi klinik jep rekomandime të karakterit praktik, me synim përmirësimin dhe korrigjimin e praktikës së ndjekur prej subjektit të auditimit.

2. Rekomandimet e dhëna duhet të marrin parasysh burimet ekonomike, kohën dhe stafin e përkushtuar dhe kontekstin, në të cilin zhvillohet auditimi, duke shërbyer si referencë në të ardhmen për praktikën klinike të ndjekur prej subjektit të audituar.

3. Subjekti i auditimit zbaton rekomandimet e evidentuara nga audituesi klinik ose paraqet kundërshtimet e tij, duke provuar zbatimin e praktikës së ndjekur sipas protokolleve mjekësore dhe të miratuara nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

4. Gjetjet nga auditimi klinik shpërndahen te të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor, nëpërmjet organizimit të mbledhjeve apo konferencave të përbashkëta me audituesin, me qëllim gjithëpërfshirjen dhe shpërndarjen e njohurive për rregullat që duhet të ndiqen gjatë praktikës klinike.

5. Një kopje e raportit të auditit klinik përcillet në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë.

Ç. Riauditimi dhe sigurimi i përmirësimeve

1. Audituesit klinikë kanë të drejtë të bëjnë verifikime periodike dhe riauditim për efektet e ndryshimeve që mund të kenë zbatuar subjektet e audituara.

2. Riauditimi i një subjekti të audituar bëhet 3 muaj pas auditimit klinik më të fundit të ushtruar.

3. Riauditimi bëhet duke mbledhur të dhëna sipas rregullave të përcaktuara në pjesën “Ç”, të



këtij kreu, dhe synon që të sigurojë se ndryshimet në praktikën klinike janë futur dhe janë zbatuar.

IV. Etika profesionale dhe papajtueshmëria

1. Auditimet klinike duhet të udhëhiqen nga parimet e mëposhtme:

a) ruajtja e privatësisë së të dhënave të pacientit, përfshirë edhe ato klinike;

b) ruajtja e anonimitetit të personave të pyetur gjatë procesit të investigimit;

c) kryerja e auditimit klinik brenda fushës së përcaktuar.

2. Gjatë kryerjes së auditimit klinik, të gjithë përdoruesve të shërbimit/kujdestarëve, stafit mjekësor dhe jomjekësor, që do të përfshihen në proces, duhet t'u bëhet me dije, me shkrim, qëllimi i auditimit klinik, ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave dhe duhet t'u merret pëlqimi me shkrim.

3. Nëse audituesi klinik, i për zgjedhur për të kryer auditim klinik, refuzon kryerjen e auditit tri herë radhazi, përjashtuar rastet kur ai refuzon se gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, atëherë ai humbet të drejtën për të qenë auditues klinik dhe hiqet nga Regjistri Kombëtar i Audituesve Klinikë.

V. Tarifat e pagesës së audituesve klinikë

1. Audituesit klinikë, të zgjedhur nga lista e audituesve dhe që do të kryejnë procesin e auditimit klinik, paguhen sipas tarifës prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh në ditë, por jo më shumë se 10 (dhjetë) ditë, për një proces auditimi klinik.

2. Pagesa do të kryhet prej institucionit të kujdesit shëndetësor, subjekt i auditimit, në përfundim të procesit të auditimit, në llogarinë e deklaruar bankare të audituesit.

VI. Hyrja në fuqi

1. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe institucionet e kujdesit shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

2. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2020.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 863, datë 24.12.2019

PËR NJË RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2019, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCË DHE EKONOMISË DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", të ndryshuar, dhe të shkronjës "b", të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2019, të bëhet rishpërndarja e fondeve ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë t'i pakësohet fondi prej 300 000 000 (treqind milionë) lekësh në programin buxhetor "Sigurimi shoqëror", të buxhetit të shtetit, për shpenzime korrente, në artikullin 604, "Transferte nga buxheti i shtetit në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore";

b) Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale t'i shtohet fondi prej 300 000 000 (treqind milionë) lekësh në programin buxhetor "Përkujdesi social", për shpenzime korrente, në artikullin 606, "Transferte për buxhetet familjare dhe individët".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 865, datë 24.12.2019****PËR MËNYRËN E KRYERJES SË
PROCESIT TË AKREDITIMIT TË
INSTITUCIONEVE TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR E PËRCAKTIMIN E
TARIFAVE DHE AFATEVE KOHORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 26, të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor, përjashtuar laboratorët mjekësorë, duhet të plotësojnë standardet bazë për akreditim.

2. Procesi i akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor realizohet nga këto struktura përgjegjëse:

a) ministri përgjegjës për shëndetësinë (në vijim, ministri);

b) institucioni përgjegjës për akreditimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor;

c) bordi i akreditimit.

3. Pas licencimit të veprimtarisë përkatëse, të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor i nënshtrohen verifikimit nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetësisë të përmbushjes së standardeve bazë për akreditim.

4. Grupet e inspektimit verifikojnë pranë institucioneve të kujdesit shëndetësor përmbushjen e standardeve bazë të akreditimit, të miratuara nga ministri dhe hartojnë raportin përkatës me institucionet që kanë përmbushur ose jo standardet bazë të akreditimit. Ky raport dërgohet pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe institucionit përgjegjës për akreditimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor.

5. Institucioni përgjegjës për akreditimin, pas marrjes së raportit, njofton institucionin e kujdesit shëndetësor që ka plotësuar standardet bazë të akreditimit dhe e fton të vijojnë procesin e akreditimit.

6. Ministri, pas marrjes së raportit për institucionet e kujdesit shëndetësor publik, që nuk

përmbushin standardet bazë të akreditimit, vendos, me urdhër, masat përkatëse për këtë institucion.

7. Ministri, pas marrjes së raportit për institucionet e kujdesit shëndetësor, jopublike, që nuk përmbushin standardet bazë të akreditimit, vendos pezullimin e licencës për një periudhë 30-ditore (tridhjetëditore). Nëse edhe pas kësaj periudhe institucioni i kujdesit shëndetësor nuk i ka përmbushur standardet bazë të akreditimit, atëherë ministri vendos revokimin e licencës.

8. Vendimi i ministrit për pezullimin e shfuqizimin e licencës së institucionit të kujdesit shëndetësor jopublik publikohet nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve dhe i përcillet për njoftim Qendrës Kombëtare të Biznesit.

9. Institucioni i kujdesit shëndetësor, që ka plotësuar standardet bazë të akreditimit, pas ftesës së marrë nga institucioni përgjegjës për akreditim, mund të vijojë procesin e akreditimit sipas procedurës së përcaktuar në këtë vendim.

10. Institucioni përgjegjës për akreditimin i jep institucionit të kujdesit shëndetësor standardet optimale për akreditim, formularët që duhet të plotësohen, si dhe dokumentacionin bashkëshoqërues ndihmës për vetëvlerësim.

11. Institucioni i kujdesit shëndetësor, pas pajisjes nga institucioni përgjegjës për akreditimin me dokumentacionin e sipërcituar, merr masat për kryerjen e vetëvlerësimit. Institucioni i kujdesit shëndetësor vlerëson vetveten përkundrejt standardeve të akreditimit dhe harton raportin/et e vetëvlerësimit, të cilat dorëzohen, brenda dy muajve pas marrjes së ftesës, pranë institucionit përgjegjës, si dhe plotëson dokumentacionin e nevojshëm për akreditim.

12. Në përfundim të vetëvlerësimit, institucioni i kujdesit shëndetësor dorëzon raportin e fundit të vetëvlerësimit dhe bën kërkesën për vlerësim të jashtëm nga ekspertët e përcaktuar nga institucioni përgjegjës për akreditim.

13. Pas dorëzimit të raportit të vetëvlerësimit, institucioni përgjegjës për akreditim, dakordëson me institucionin e kujdesit shëndetësor datën e vlerësimit të jashtëm brenda një afati 10-ditor (dhjetëditor).

14. Kohëzgjatja nga momenti i marrjes së ftesës për akreditim deri në vizitën përfundimtare të



ekspertëve të vlerësimit të jashtëm nuk duhet të kalojë periudhën 6-mujore (gjashtëmujore).

15. Institucioni përgjegjës për akreditimin harton programin e vlerësimit të jashtëm akreditues dhe njofton paraprakisht titullarin e institucionit shëndetësor për programin që do të ndjekë ekipi i vlerësuesve të jashtëm dhe përbërjen e tij. Njëri nga anëtarët e ekipit zgjidhet si drejtues i ekipit. Ekspertët e përzgjedhur për të kryer vlerësimin e jashtëm trajnohen nga institucioni përgjegjës për akreditim sipas një programi të miratuar nga bordi i akreditimit dhe plotësojnë një deklaratë që nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

16. Vizita e ekspertëve të vlerësimit të jashtëm akreditues kryhet në datat e paracaktuara nga institucioni përgjegjës për akreditimin dhe institucioni i kujdesit shëndetësor. Institucioni duhet t'i ofrojë ekipit kushte optimale pune, pavarësi, mbrojtje dhe mbështetje nga çdo ndikim.

17. Grupi i ekspertëve të vlerësimit të jashtëm harton brenda 2 (dy) javësh draftraportin e vlerësimit lidhur me përmbushjen me standardet dhe ia paraqet institucionit të kujdesit shëndetësor dhe institucionit të vetëvlerësuar për komente e sugjerime të mundshme.

18. Grupi i ekspertëve të vlerësimit të jashtëm mund të marrë parasysh ose jo vërejtjet e institucionit të kujdesit shëndetësor dhe, brenda një jave, dorëzon raportin final të vlerësimit të firmosur nga të gjithë anëtarët e ekipit pranë institucionit përgjegjës për akreditimin, i cili i jep një kopje të këtij raporti institucionit të kujdesit shëndetësor.

19. Pas marrjes në dorëzim të raportit final nga grupi i ekspertëve të vlerësimit të jashtëm, institucioni përgjegjës për akreditimin përgatit për mbledhjen e ardhshme të bordit të akreditimit dosjen e plotë të akreditimit.

20. Ekspertët e vlerësimit të jashtëm paguhen me një tarifë ditore prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh, të cilat përballohen nga institucioni përgjegjës për akreditimin.

21. Ministri vendos për akreditimin ose jo të institucionit të kujdesit shëndetësor, pasi shqyrton rekomandimet e bordit të akreditimit dhe vendos të miratojë atë ose ta kthejë për rivlerësim nëse e gjykon të arsyeshme brenda një afati 30-ditorë (tridhjetëditor).

22. Bordi i akreditimit të institucioneve shëndetësore ngrihet pranë ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë:

a) një përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë;

b) dy përfaqësues të institucionit përgjegjës për akreditimin;

c) një profesionist shëndetësor me gradë shkencore ose titull akademik, i përzgjedhur nga ministri;

ç) një përfaqësues i Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

23. Emërimi dhe shkarkimi i kryetarit dhe i anëtarëve të bordit të akreditimit bëhen me urdhër të ministrit.

24. Bordi i akreditimit mbledhet jo më pak se 6 (gjashtë) herë në vit. Anëtari i këtij bordi, i cili mungon pa arsye në 1/3 e mbledhjeve, zëvendësohet.

25. Anëtarët e bordit të akreditimit duhet të respektojnë aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë konfliktin e interesit.

26. Mbledhja e bordit të akreditimit zhvillohet kur marrin pjesë jo më pak se 3 (tre) anëtarë.

27. Bordi i akreditimit miraton rregulloren e funksionimit të tij të brendshëm.

28. Bordi i akreditimit mbështetet nga sekretariati teknik, i përbërë nga nëpunës të institucionit përgjegjës për akreditim, të caktuar nga titullari.

29. Bordi i akreditimit ka të drejtë që të thërrasë specialistë të fushave shëndetësore, rast pas rasti, në varësi të profilin të institucionit shëndetësor që do të akreditohet.

30. Bordi i akreditimit ka këto detyra dhe përgjegjësi:

a) shqyrton raportet përfundimtare të vlerësimit të jashtëm të cilësisë për akreditim të parë dhe periodik;

b) harton e dërgon rekomandimin për ministrin, bazuar në raportin e vlerësuesve të jashtëm;

c) kërkon të dhëna e dokumente të mëtejshme nga institucioni përgjegjës për akreditimin dhe institucioni i kujdesit shëndetësor që është në vlerësim;

ç) dëgjon e shqyrton ankesat e mundshme të institucioneve që i janë nënshtruar vlerësimit të jashtëm dhe vendos për to;

d) miraton kriteret specifike të përzgjedhjes së ekspertëve të vlerësimit;



dh) miraton listën vjetore të ekspertëve të përzgjedhur si vlerësues;

e) miraton programin e trajnimit të ekspertëve të vlerësimit.

31. Anëtarët e bordit të akreditimit shpërblehen sipas legjislacionit në fuqi për shpërblimin e anëtarëve të bordeve/komiteteve/komisioneve.

32. Bordi i akreditimit merr në shqyrtim dokumentacionin përkatës të dosjes të sipërpërmendur dhe, me shumicë votash, rekomandon:

a) akreditimin e plotë për 5 (pesë) vjet kur realizimi i standardeve optimale është >85%;

b) akreditimin e pjesshëm 1–3 (një deri në tre) vjet kur realizimi i standardeve optimale është >70%;

c) mosdhënien e akreditimit kur realizimi i standardeve optimale është <70%.

33. Institucioni përgjegjës për akreditimin i dërgon rekomandimin e bordit të akreditimit ministrit, i cili, bazuar në rekomandimin e bordit të akreditimit, merr vendimin për akreditimin ose jo të institucionit të kujdesit shëndetësor, brenda një afati 30-ditor (tridhjetëditor).

34. Kundër vendimit të ministrit bëhet ankim në gjykatë brenda 30 (tridhjetë) ditëve.

35. Institucioni përgjegjës për akreditimin bën publike certifikatën dhe emblemën e akreditimit, të cilat institucioni i kujdesit shëndetësor ka të drejtë t'i afishojë në një vend të dukshëm për publikun.

36. Format i certifikatës së akreditimit dhe i emblemës miratohen me urdhër të ministrit.

37. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë shpall publikisht listën e institucioneve të akredituara dhe të atyre që nuk kanë përmbushur standardet bazë për akreditim.

38. Tarifat për kryerjen e gjithë procesit të akreditimit janë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Të ardhurat e mbledhura nga tarifatat për procesin e akreditimit derdhen 50 (pesëdhjetë) % në buxhetin e institucionit përgjegjës për akreditim dhe 50 (pesëdhjetë) % në buxhetin e shtetit. Të ardhurat dytësore të realizuara nga aplikimi i tarifave të procesit të akreditimit, që derdhen për llogari të institucionit përgjegjës për akreditim, klasifikohen si të ardhura jashtë limitit (kapitulli VI). Kriteret dhe mënyra e përdorimit të tyre përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

39. Vendimi nr. 315 datë 23.3.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe për mënyrën e realizimit të procesit të akreditimit të institucioneve shëndetësore”, i ndryshuar, shfuqizohet.

40. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

ANEKSI 1

TARIFAT PËR REALIZIMIN E PROCESIT TË AKREDITIMIT TË INSTITUCIONEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Tarifat për realizimin e procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor janë, si më poshtë vijon:

a) akreditim i strukturave shëndetësore universitare	400 000 lekë;
b) akreditim i spitaleve private	400 000 lekë;
c) akreditim i spitaleve ditore	150 000 lekë
ç) akreditim i spitaleve rajonale publike	200 000 lekë;
d) akreditim i spitaleve bashkiake publike	100 000 lekë;
dh) akreditim i qendrave shëndetësore	60 000 lekë;
e) akreditim i kabineteve mjekësore	50 000 lekë;
ë) qendër mjekësore	200 000 lekë;
f) akreditim i shërbimeve shëndetësore brenda spitalit	100 000 lekë
g) akreditim i klinikave stomatologjike	200 000 lekë;
gj) akreditim i kabineteve stomatologjike	50 000 lekë;
h) akreditim i farmacive	50 000 lekë;



VENDIM
Nr. 869, datë 24.12.2019

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE ME SHKËMBIM
NOTASH TË MARRËVESHJES SË
GRANTIT (GRANT NR. TF017364),
NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM, QË VEPRON SI
AGJENCI ZBATUESE PËR FONDIN
GLOBAL TË MJEDISIT (GEF), PËR
PROJEKTIN E SHËRBIMEVE
MJEDISORE, RATIFIKUAR ME LIGJIN
NR. 152/2014

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim notash të marrëveshjes së grantit (grant nr. TF017364), ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si agjenci zbatuese për Fondin Global të Mjedisit (GEF), për projektin e shërbimeve mjedisore, ratifikuar me ligjin nr. 152/2014, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Banka Botërore
IBRD ° IDA GRUPI I BANKËS BOTËRORE
Pratertrasse 31/21
Vienna, Austria, 1020
LINDA VAN GELDER

Drejtore Rajonale për Ballkanin Perëndimor,
Evropën dhe Azinë Qendrore

30 shtator 2019

Sh. S. Anila Denaj
Ministre e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë, Shqipëri

E nderuar znj. Ministre,
Projekti i Shërbimeve Mjedisore në Shqipëri
Fondi për Mjedis Global TF nr. TF017364
Zgjatje e Afatit të Mbylljes

I referohemi Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Përfituesi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), në funksionin e agjencisë zbatuese për Fondin për Mjedis Global (GEF), të datës 25 korrik, 2015 për Projektin e Shërbimeve Mjedisore (“Projekti”) dhe letres suaj, datë 12 shtator 2019, ku Bankës Botërore i kërkohet zgjatje e afatit të mbylljes së Grantit të sipërpërmendur, nga 30 shtator 2019 deri në datën 30 shtator 2020.

Kemi kënaqësinë t’ju njoftojmë se Banka Botërore ka caktuar datën 30 shtator 2020, si datë të mëvonshme për qëllime të paragrafit IV.B.2, të skedulit 2, të Marrëveshjes së Grantit.

Me respekt,
Nënshkrimi
Linda Van Gelder

Drejtore Rajonale për Ballkanin Perëndimor,
Evropën dhe Azinë Qendrore

Në vëmendje të: SHT Blendi Klosi - ministër i Turizmit dhe Mjedisit

Z. Erjon Luci - zëvendësministër i Financave

Znj. Petra Burcher - shefe e Bashkëpunimit për Zhvillim - pranë Ambasadës Suedeze

Z. Tomas Nystrom, drejtues Programi, Ambada Suedeze

Znj. Majlinda Dhuka, zëvendëssekretare e përgjithshme dhe Drejtore e Përgjithshme e Departamentit për Zhvillim dhe Mirëqeverisje

Z. Patrizio Pagano, drejtor ekzekutiv, Banka Botërore, SHS Anila Denaj

Miratuar nga: Kseniya Lvovsky, Manaxhere e Praktikave, GENEC - Damir Leljak (WFACS)

Për dijeni: Linda Van Gelder, Maryam Salim, Kseniya Lvovsky, Luis M.Schwarz, Damir Leljak, Drita Dade, Silvia Mauri, Arben Maho, Jonida Myftiu, Bekim Imeri, Esma Kreso, Elona Qana, Simon Ellis, Lada Strellkova, Goran Tinjic, Daria Lavrentieva, Valentina Martinovic, Nejme Kotere, Evis Sulko, Luz Meza-Bartrina, Nadeem Mohammad, Albania DL, ECA Operations,



Drejtor GENEK GP, ECCWB Ekipi Manaxherial (ECCWB DMT), WB Docs.

Person kontakti: Drita Dade (numri i brendshëm 5246 137)

VENDIM

Nr. 871, datë 24.12.2019

PËR CAKTIMIN E DITËS SË PREMTE, DATË 3.1.2020, DITË PUSHIMI

Në mbështetje të neneve 95, pika 2, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e ditës së premte, datë 3.1.2020, ditë pushimi për punonjësit e administratës shtetërore.

2. Dita e punës e datës 3.1.2020, do të zëvendësohet në një nga ditët e pushimit brenda muajit janar.

3. Ngarkohen institucionet e administratës shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 872, datë 24.12.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 673, DATË 22.11.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR RIORGANIZIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në kreun II bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijojnë:

a) në pikën 5 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. shkronja “ë” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ë) ofron shërbimin e nënshkrimit elektronik, vulën elektronike, certifikatën elektronike për organet e institucionet e administratës publike dhe subjektet private, sipas tarifave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave. Përcaktimi i tarifave sipas kësaj shkronje bëhet me propozimin e AKSHI-t dhe miratimin e ministrit përgjegjës për financat dhe ekonominë.”;

ii. në shkronjën “j”, fjalët “lidh kontrata” hiqen;

iii. pas shkronjës “j” shtohet shkronja “k”, me këtë përmbajtje:

“k) përgjigjet për ngritjen, mirëmbajtjen e sistemeve dhe të aplikacioneve të teknologjisë së informacionit e komunikimit për infrastrukturën e qendëruar dhe infrastrukturën TIK, për njësitë e qeverisjes vendore (NJQV) (bashkitë), me kërkesë të tyre.”;

b) pas pikës 5 shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“5/1 Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit është pika hyrëse e Rrjetit të Shërbimeve Transevropiane për Telematikën ndërmjet Administratave, në Republikën e Shqipërisë, e cila ushtron kompetencat kryesore, si më poshtë vijon:

a) është përgjegjës për t’iu përgjigjur përdoruesve të *domain*-it të saj lokal, të cilët nuk janë të autorizuar të kontaktojnë drejtpërdrejt me mbështetjen qendrore të Rrjetit të Shërbimeve Transevropiane për Telematikën ndërmjet Administratave;

b) merr masa për të lehtësuar ndërveprimin ndërmjet *domain*-it evropian dhe *domain*-it lokal;

c) posedon hapësirë të mjaftueshme dhe siguron të gjitha mjetet logjistike për komunikimin me rrjetin TESTA;

ç) merr të gjitha masat e nevojshme të sigurisë për funksionimin operacional të *domain*-it;

d) ndjek e zbaton detyrimet reciproke të përcaktuara në memorandumin e mirëkuptimit, që do të nënshkruhet për këtë qëllim me Drejtorinë e



Përgjithshme të Informatikës në Komisionin Evropian.”;

c) në pikën 6 bëhen këto ndryshime:

i. shkronja “d” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d) ofron shërbimet e autentifikimit, të nënshkrimit elektronik, të vulës elektronike dhe të certifikatës elektronike për organet dhe institucionet e administratës publike e subjektet private.”.

ii. në shkronjën “e”, fjalët “... sipas tarifave të miratuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat dhe ekonominë ...” zëvendësohen me fjalët “... sipas tarifave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave. Përcaktimi i tarifave sipas kësaj shkronje bëhet me propozimin e AKSHI-t dhe miratimin e ministrit përgjegjës për financat dhe ekonominë ...”.

2. Në kreun III bëhen këto ndryshime:

a) në pikën 14, fjalët “... bordi për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (BTIK) ...” zëvendësohen me “... Këshilli Kombëtar për Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (KKTIK) ...”;

b) në pikën 15, emërtimi “BTIK” zëvendësohet me “KKTIK”.

3. Në listën nr. 1, “Katalog shërbimesh”, bashkëlidhur vendimit, pas shërbimit “vulë elektronike” shtohet “certifikatë elektronike”, sipas shtojcës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe të gjitha institucionet e organet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA

Certifikata elektronike	Certifikatë elektronike X.509v3	AKSHI	Administrata publike, subjektet/bizneset
--------------------------------	---------------------------------	-------	--

VENDIM

Nr. 873, datë 24.12.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 389, DATË 12.6.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRITERET PËR LËSHIMIN E PASAPORTËS DIPLOMATIKE DHE ASAJ TË SHËRBIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 8668, datë 23.11.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shteti”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 389, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) në pikën 10, fjalët “... 31 dhjetor 2020 ...” zëvendësohen me “... 31 dhjetor 2021 ...”;

b) në pikën 14, fjalët “... 31 dhjetor 2019 ...” zëvendësohen me “... 30 qershor 2020 ...”.

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për punët e jashtme, ministria përgjegjëse për punët e brendshme dhe institucionet e tjera publike, zyrtarët apo subjektet e të cilëve pajisjen me pasaporta diplomatike apo shërbimi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 874, datë 24.12.2019

PËR MËNYRËN E OFRIMIT TË NDIHMESËS PERSONALE DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË NDIHMËSIT PERSONAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 8, të ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

I. MËNYRA E OFRIMIT TË NDIHMESËS PERSONALE

1. Ndhmësi personal është ai individ i zgjedhur dhe i udhëzuar nga një person me aftësi të kufizuara, për ta ndihmuar këtë të fundit që të kapërcejë pengesat në jetën e përditshme.

2. E drejta e përfitimit të ndihmësit personal përcaktohet, nga:

a) komisionet mjekësore për caktimin e aftësisë për punë;

b) Komisioni Mjekësori i Përcaktimit të Verbërisë;

c) komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar.

3. Ndhmësi personal ofron ndihmesën/asistencën personale në cilësinë e ndihmësit, për:

a) kujdesin personal për personat me aftësi të kufizuara;

b) shoqëruesit për personat e verbër;

c) interpretuesit e gjuhës së shenjave; dhe

ç) lehtësuesit në komunikim për personat me aftësi të kufizuara, në të folur dhe në të dëgjuar.

4. Ndhmësit personalë ofrojnë ndihmesën/asistencën personale, sipas përcaktimeve në këtë vendim, për të mundësuar realizimin e veprimtarive bazë të jetës së personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me moshën në familje dhe në shoqëri dhe për të siguruar një pjesëmarrje aktive në jetën e komunitetit.

5. Detyrat e ndihmësit personal përfshijnë, por nuk kufizohen, në detyrat e përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, dhe synojnë t'i vijnë në ndihmë personit me aftësi të kufizuara, për:

a) realizimin e veprimtarive për përmbushjen e nevojave themelore për t'u mundësuar atyre të jetojnë me dinjitet;

b) shoqërimin jashtë shtëpisë për të siguruar pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe fetare;

c) shoqërimin për marrjen e shërbimeve sociale, shëndetësore, rehabilituese e integruese dhe shoqërimi për në shkollë për fëmijët e moshës shkollore;

ç) marrjen në kohë të mjekimeve, sipas rekomandimit të mjekut; dhe

d) mbajtjen e higjienës personale.

6. Mbështetja në komunikim përfshin, por nuk kufizohen te:

a) shërbimet e përkthyesit të gjuhës së shenjave;

b) ndihma për të komunikuar nëpërmjet ligjërimit dhe/apo shenjave të veçanta;

c) ndihma në përdorimin e programeve që ndihmojnë komunikimin përmes figurave;

ç) përshtatja e informacionit të shkruar, sipas nevojave.

7. Ndhmësit personalë ofrojnë ndihmesën/asistencën personale nën drejtimin dhe udhëzimet e vetë personave me aftësi të kufizuara, edhe në rastet kur personi me aftësi të kufizuara është asistuar nëpërmjet mbështetjes me ndihmë në vendimmarrje, ose nën drejtimin dhe udhëzimet e përfaqësuesve ligjorë të personave me aftësi të kufizuara.

8. Ndhimesa/asistenca personale ofrohet në përputhje me nevojat, mundësitë, rrethanat e jetës, dhe dëshirat e personave me aftësi të kufizuara, si edhe në mirëkuptim ndërmjet palëve.

9. Ndhmësit personalë ofrojnë ndihmesën/asistencën personale, në respekt të të drejtave dhe lirive të personit me aftësi të kufizuara, duke mos cenuar dinjitetin dhe pavarësinë e tij, si edhe duke garantuar lirinë e zgjedhjes, të pjesëmarrjes, të përfshirjes së plotë dhe efektive, ruajtjen e konfidencialitetit dhe të privatësisë.

II. DOKUMENTACIONI DHE KRITERET E PËRZGJEDHJES SË NDIHMËSIT PERSONAL

1. Ndhmësi personal zgjidhet nga vetë përfituesi dhe/ose nëpërmjet mbështetjes me ndihmë në vendimmarrje, ose nga kujdestari ligjor, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

2. Shërbimet e ndihmësit personal mund të ofrohen nga:

a) anëtarë të familjes;

b) kujdestarë ligjorë;

c) të afërm ose miq;

ç) punonjës të fushës sociale apo çdo person tjetër që ka marrë kualifikimet e kërkuara për ofrimin e këtij shërbimi;

d) subjektet publike/jopublike që ofrojnë shërbime të ndihmësit personal, për ofrimin e këtij shërbimi, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

dh) organizata shërbimesh, të ngritura nga persona me aftësi të kufizuara.

3. Ndhmësi personal paraqet pranë administratorit shoqëror të njësisë administrative kopjen e kartës së identitetit.



4. Administratori shoqëror kontakton personin me aftësi të kufizuara/përfaqësuesin ligjor të tij dhe merr konfirmimin e tij/saj për ndihmësin personal të përzgjedhur.

Për personat me aftësi të kufizuara, të cilëve me vendim gjykatë i është caktuar kujdestar ligjor, administratori shoqëror siguron kopje të vendimit të gjykatës, të cilën e bën pjesë të dosjes.

5. Listat emërore, së bashku me numrin personal të kartës së identitetit të personave që ofrojnë shërbimin e ndihmesës/asistencës personale të personave me aftësi të kufizuara, dërgohen nga bashkitë pranë drejtorive rajonale të shërbimit social shtetëror, nën juridiksionin e së cilës përfshihen, për t'u hedhur në Regjistrin Kombëtar Elektronik.

6. Për t'u përzgjedhur në cilësinë e ndihmësit personal, duhet të plotësohen këto kritere:

- a) të jetë në moshë madhore, mbi 18 vjeç;
- b) të mos jetë i dënuar me vendim gjykatë, të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale, kundërvajtjeje penale me dashje apo me vendim gjykatë për dhunë në marrëdhëniet familjare;
- c) të jetë i aftë për t'i shërbyer personit me aftësi të kufizuara;
- ç) të ketë njohuritë bazë mbi aftësinë e kufizuar, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si edhe mbi etikën në ofrimin e ndihmës/asistencës shtëpiake, sjellje e komunikim ose të jetë i gatshëm t'i përfitojë këto njohuri në një kohë sa më të shpejtë, me qëllim që të garantojë cilësinë e shërbimit të ofruar;
- d) të ketë marrë udhëzime përgatitore nga përfutuesi për të ofruar shërbimet e ndihmësit personal;
- dh) të shprehë gatishmëri për të marrë trajnime të tjera, sipas nevojës.

7. Subjektet publike/jopublike, që ofrojnë shërbime të ndihmësit personal, duhet të jenë të licencuar sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, për kryerjen e shërbimeve që marrin përsipër.

8. Ndihmësit personalë duhet të kualifikohen në vazhdimësi për mënyrat e ofrimit të shërbimit të ndihmesës/asistencës personale, sipas përcaktimeve të shkronjës “ç”, të pikës 6, të këtij kreu.

9. Shërbimi Social Shtetëror harton modulet e trajnimit për shërbimin e ndihmesës/asistencës personale dhe përgatit stafet e shërbimeve sociale

pranë bashkive për të ofruar trajnimet e ndihmësve personalë.

III. MONITORIMI I NDIHMESËS / ASISTENCËS PERSONALE DHE MBËSH-TETJA PËR NJË SHËRBIM CILËSOR

1. Monitorimi i shërbimeve të ndihmësit personal bëhet nga personi me aftësi të kufizuara ose përfaqësuesi i tij.

2. Administratorët shoqërorë përgjegjës për çështje të personave me aftësi të kufizuara, të cilët koordinojnë mbështetjen në lidhje me shërbimet e ndihmësit personal, kanë njohuri bazë për çështjet e aftësisë së kufizuar dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

3. Administratorët shoqërorë janë përgjegjës, për:

- a) hartimin e një plani individual të përvitshëm të shërbimeve, mbështetur në rekomandimet e komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit;
- b) kryerjen e vizitave në mjedisin ku jeton individ, jo më pak se dy herë në vit;
- c) informimin e zyrës së vlerësimit mbi ndryshimin e gjendjes së personit me aftësi të kufizuara;
- ç) informimin e individëve për shërbimet shëndetësore, arsimore dhe rehabilituese ekzistuese, nën juridiksionin e bashkisë/njësisë administrative në territorin e së cilës është banor individ;
- d) informimin e individëve për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë për vlerësim/rivlerësim të aftësisë së kufizuar;
- dh) informimin e familjarëve për të drejtat e personit me aftësi të kufizuara, për t'u përfshirë në të gjitha aspektet e jetës shoqërore;
- e) monitorimin dhe mbështetjen e shërbimit të asistencës personale;
- ë) evidentimin, raportimin dhe referimin e rasteve të abuzimit e të neglizhencës;
- f) organizimin dhe realizimin, sipas nevojës, të trajnimeve të ofruesve të shërbimeve të ndihmësit personal.

IV. DISPOZITË E FUNDIT

Ngarkohen Shërbimi Social Shtetëror, në nivel qendror e rajonal, dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



VENDIM

Nr. 876, datë 18.12.2019

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/ NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, me këtë përmbajtje:

a) Në fund të pikës 1/1 shtohet emërtesa “Prokuroria e Posaçme”.

b) Pas pikës 7/2 shtohet pika 7/3, me këtë përmbajtje:

“7/3 Nivelet e pagave për funksionarët e kabinetit në Prokurorinë e Posaçme janë sipas lidhjes nr. 4/3/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve në Prokurorinë e Posaçme janë sipas lidhjes nr. 4/3/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2019, të përballohen nga fondet e miratuara për Prokurorinë e Posaçme dhe të fillojnë nga momenti i transferimit apo i emërimit të funksionarëve dhe të nëpunësve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

Lidhja nr. 4/3/a

**NIVELET E PAGAVE PËR FUNKSIONARËT E KABINETIT
NË PROKURORINË E POSAÇME**

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PÛRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Këshilltar në kabinetin e drejtuesit të Prokurorisë	I-b	1
Sekretar i drejtuesit të Prokurorisë	Barazohet në pagë me sekretarin e Kryeministrit	



Lidhja nr. 4/3/b

KATEGORITË E PAGAVE TË POZICIONEVE TË PUNËS SË NËPUNËSVE
NË PROKURORINË E POSAÇME

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Kancelar	I-a	1
Drejtor drejtorie Ekspert	II-b	1
Përgjegjës sektori	III-a	1
	III-a/1	
Specialist	III-b	1 ose 2
Specialist	IV-a	1 ose 2, ose 3
	IV-b	

VENDIM

Nr. 877, datë 18.12.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 717, DATË 23.6.2009, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PAGAT E
PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË
INSTITUCIONEVE BUXHETORE DHE
TË NËPUNËSVE TË DISA
INSTITUCIONEVE BUXHETORE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. I/4, “Renditja e pozicioneve të punës për çdo klasë për nëpunësit dhe punonjësit mbështetës në administratën e Prokurorisë së Përgjithshme”, e vendimit nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, e ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen nr. I/4, “Renditja e pozicioneve të punës për çdo klasë për nëpunësit dhe punonjësit mbështetës në administratën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Prokurorisë së Posaçme”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2019, të përballohen nga buxheti i miratuar për Prokurorinë e Posaçme.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



Lidhja nr. I/4

**RENDITJA E POZICIONEVE TË PUNËS PËR ÇDO KLASË PËR NËPUNËSIT DHE PUNONJËSIT
MBËSHTETËS NË ADMINISTRATËN E PROKURORISË SË PËRGJITHSHME DHE NË
PROKURORINË E POSAÇME**

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Oficer informacioni dhe i ruajtjes së rendit Oficer informacioni në Prokurorinë e Posaçme Sekretare Punonjës i postës sekrete	VIII	
2	Shofer i drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Teknik mirëmbajtjeje Operator Magazinier	VII	
3	Shofer i postës sekrete Kuzhinier në Prokurorinë e Posaçme	VI	
4	Shoferë të tjerë të institucionit	V	
5	Punonjës pastrimi	III	

Shënim. Për emërtesa të tjera, kur janë të njëjta me institucionet e tjera qendrore, përdoret lidhja I/1 e vendimit.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 616 lekë